



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

Raport Përfundimtar Auditimi Performance

“Efektiviteti i programit të integruar për zhvillimin rural - Programi i 100 Fshatrave”



Tiranë, Shtator 2022

P Ë R M B A J T J A

I. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	4
1.1 Konteksti i problemit social	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	4
II. SUBJEKTET NËN AUDITIM	5
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.	5
2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjen nën auditim.....	9
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	11
2.4 Pesha në buxhet.....	12
2.5 Feedback-u i subjektit përgjatë gjithë auditimit.....	13
III. DETAJET E AUDITIMIT	13
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	13
3.2 Objektivat e auditimit	14
3.3 Pyetjet e auditimit	15
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	16
IV. SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	17
MESAZHI I AUDITIMIT	17
PYETJA KRYESORE - A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e “Programit 100 Fshatrat”?	17
IV.1 A janë arritur objektivat e përcaktuara në Strategji (PIZHR), “Programi i 100 fshatrave”?	18
IV.1.1 A i ka shërbyer koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional, përmbushjes me sukses të objektiveve/detyrimeve që burojnë nga Strategjia?	18
IV.1.2 A ka monitoruar MBZHR, në rolin e udhëheqësit të Strategjisë, zbatimin e PIZHR?	21
IV.2 A janë marrë masat e duhura për të mbuluar me financim “Programin e 100 fshatrave”, me qëllim arritjen e objektiveve?	22
IV.2.1 A është siguruar mbështetje financiare nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në program dhe nga mekanizmat e tjerë financiarë?	22
IV.2.2 A i ka shërbyer mbështetja financiare realizimit të objektiveve të “Programit të 100 fshatrave”?	30
IV.3 A kanë ndikuar procedurat e ndjekura nga strukturat MTM, AKPT, AZHBR për realizimin e Programit të 100 fshatrave?	43
IV.3.1 A i ka shërbyer realizimi i deritanishëm i “Programit të 100 fshatrave”, grupeve të synuara, (popullsia e zonave rurale, fermerët grupet e fermerëve, individë, në veçanti gratë dhe të rinjtë)?	44
IV.3.2 A është monitoruar realizimi i treguesve, për të matur impaktin që synon të arrijë PIZHR dhe a është përfshirë komuniteti në dëgjesa publike?	44
V. PËRMBLEDHJA	46
VI. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	47
VII. SHTOJCAT	48
7/1 Foto dhe komente mbi gjëndjen në terren:	48
7/2 Aneksë:	58
Aneksi A -Lista e agroturizmit dhe turizmit rural në total dhe për 100 fshatrat në veçanti	58
Aneksi B: Tabela mbi projektet e 100 fshatrave nga FSHZH, te cilat janë në fazat fillestare:	59
Aneksi C: Tabela total e paraqitur nga FSHZH në MBZHR si punë e kryer për 100 fshatrat:	61
Aneksi D: Formularët e disponuar nga MTM mbi burimet natyrore, kulturore, socio ekonomike, aktivitetet dhe prodhimet lokale, etj te paraqitura nga bashkitë dhe njësitë administrative (67 nga 100 fshatra),	66
Aneksi E: Lëvizjet PBA ó Buxhet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:	75
Aneksi F: Lista e 100 fshatrave të miratuar me VKM nr.21, datë 12.01.2018, òPër disa shtesa në VKM nr 709, datë 29.10.2014...ò.	75

LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
MK	Ministria e Kulturës
MTM	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
EUROSAI	European Organization of Supreme Audit Institutions - Organizata Europiane e Institucioneve të Larta të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit ó (International Organization of Supreme Audit Institutions)
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit- (International Standards of Supreme Audit Institutions)
KM	Këshilli i Ministrave
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
3E	Ekomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
KA	Kritere Audituese
SK	Strategjia Kombëtare
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
KB	Këshilli Bashkiak
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
PBA	Program Buxhetor Afat Mesëm
AZHBR	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural
PIZHR	Programi i Integruar për Zhvillimin Rural
AZHR	Agjencitë e Zhvillimit Rajonal
UKM	Udhëzim i Këshillit të Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
IPARD	Instrumenti i asistencës së para aderimit për zhvillimin bujqësor dhe rural
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
SRD	Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural (Sustainable Rural Development)
FAO	Organizata për ushqim dhe bujqësi (The Food and Agriculture Organization)
SŴG	The Regional Rural Development Standing Working Group (S G) In South-East Europe.
EMP	Ekipi i Menaxhimit të Programit.
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
IKTK	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
INSTAT	Instituti i Statistikave
UBT	Universiteti Bujqësor i Tiranës
FE/UT	Fakulteti i Ekonomisë/Universiteti i Tiranës
FB	Facebook
IG	Instagram
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UKM	Udhëzim i Këshillit të Ministrave
DPPI	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale


I. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Zhvillimi Rural është një element i rëndësishëm i politikave zhvillimore të një vendi dhe pjesë komplementare përkrah politikave të bujqësisë. Zhvillimi rural konsideron integrimin e instrumenteve të zhvillimit të hapësirës rurale, që lidhen ngushtë me zhvillimin e infrastrukturës, diversifikimin ekonomik, ruajtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore si dhe zhvillimin e kapitalit social dhe njerëzor.

Fshati, si strukturë thelbësore e hapësirës rurale, përballet me sfida të mëdha, mundësi të pakta për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike përtej bujqësisë, të cilat kanë sjell migrim masiv drejt zonave urbane të vendit dhe emigracion të lartë në shtete të tjera. Ky sektor, pavarësisht potencialit, haset në disa kufizime, siç është infrastruktura rrugore dhe transporti jo i përshtatshëm publik, që pengon rritjen e kërkesës, gjithashtu edhe niveli i ulët i arsimit në zonat rurale apo emigrimi, sjell mungesë në staf të kualifikuar.

Në kontekstin e zhvillimit të vendit dhe në kuadër të adresimit të sfidave me të cilat përballet fshati hapësira rurale, është krijuar një program i posaçëm **Programi i Integruar për Zhvillimin Rural** (PIZHR) ó **Programi i 100 fshatrave**. Ky program është në zbatim të politikave qeveritare të viteve 2017-2021, Strategjisë Kombëtare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020 si dhe dokumenteve të tjera strategjike si marrëveshja e programit IPARD 2014-2020, strategjia dhe plan veprimi për turizmin 2014-2020. Synimi i këtij programi është ndërtimi i një modeli zhvillimi rural, bazuar tek potenciali turistik, duke zhvilluar rrjetëzime të investimeve në agroturizëm ku të përfshihen infrastrukturë, agroturizëm, trashëgimi kulturore dhe nxitje të punësimit përmes mbështetjes direkte për sipërmarrjen. Programi i Integruar për Zhvillimin Rural, duke u fokusuar tek potencialet turistike të zonës rurale, si një territor i pa eksploruar në Shqipëri për vite me radhë, synon transformimin ekonomik dhe social në fshat, për të krijuar 100 zona zhvillimi ekonomik rural (aneks F, lista e 100 fshatrave të miratuar), të bazuar tek investimet në agroturizëm, duke shfrytëzuar trashëgiminë kulturore, mrekullitë natyrore, traditën në tërësi. Kombinimi i të gjitha këtyre sjellin kushte të reja, për ta parë të ardhmen në fshat si një të ardhme të lidhur jo thjesht me prodhimin bujqësor në funksion të tregut në ofrimin e produkteve bujqësore, por edhe si zhvillim turistik me bazë bujqësore dhe blegtorale.



1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi në vetvete është një instrument thelbësor i procesit të llogaridhënies, për shpenzimin e parave publike, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Ndërsa nëpërmjet auditimit të performancës bëhet një shqyrtim i pavarur për të kuptuar nëse angazhimet qeveritare, operacionet, programet, aktivitetet apo institucionet e saj janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efencës dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim, në aktivitetin e tyre. Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon midis të tjerave, veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë publikë, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre ka rezultuar me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës së tyre. KLSH nëpërmjet auditimit bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e

pronës publike dhe ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, procedurat, legalizimet, kryerjen në kohë e me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj.¹

Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti, nga KLSH, bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI 2017-2023. Sipas kësaj Strategjie, KLSH ka për objektiv rritjen e cilësisë së auditimit dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, nëpërmjet Audituesve të përgatitur dhe të mirë-trajnuar. Tematika e auditimeve të performancës nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 26.11.2021.²

Ky auditim, ka në fokus kryesisht Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, të ndryshuar si dhe efektivitetin e politikave dhe rregulloreve kryesore që koordinojnë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, duke u shkëputur nga ndërhyrjet e copëzuara dhe me qasje strikte sektoriale, që po ndodhin apo pritet të ndodhin në vend. Targetimin e objektivave të matshëm për zhvillimin e hapësirës rurale, nëpërmjet fokusit të qendëruar (programim i integruar dhe i koordinuar) i investimeve publike, atyre të donatorëve dhe i investimeve private, në hapësirën e mirë përcaktuar të 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomik-sociale, të agroturizmit e turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore.

Nëpërmjet këtij auditimi, KLSH synon të vlerësojë performancën e implementimit të Programit të Integruar për Zhvillimin Rural ó Programi i 100 fshatrave, në nivel vendor dhe qendror i cili realizohet nëpërmjet subjekteve nën auditim:

Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural;

Ministria e Kulturës;

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit;

Agjencitë e tyre të varësisë.

Bazuar sa më lart, ky lloj auditimi ka si synim të rekomandojë përmirësimet për zbatimin e politikave për të rritur efektivitetin e zbatimit të programit qeveritar, për rritjen zhvillimin e 100 fshatrave +.

II. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.

Në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, që i bashkëlidhet vendimit nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, me VKM nr. 21, datë 12.1.2018 janë bërë disa shtesa dhe ndryshime, të cilat synojnë të koordinojnë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, duke u shkëputur nga ndërhyrjet e copëzuara dhe me qasje strikte sektoriale, që po ndodhin apo pritet të ndodhin në vend. PIZHR ó Programi i 100 fshatrave ka një qasje të integruar për zhvillimin rural do të targetojë objektiva të matshëm për zhvillimin e hapësirës rurale, nëpërmjet fokusit të qendëruar (programim i integruar dhe i koordinuar) i investimeve publike, atyre të donatorëve dhe i investimeve private, në hapësirën e mirëpërcaktuar të 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomik-sociale, të agroturizmit e turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore³.

¹ Neni 6 i Ligjit nr. 154/2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

² Manuali i Auditimit të Performancës.

³ Vendim nr.21, datë 12.1.2018 për disa shtesa në Vendimin nr.709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020

Institucionet e përzgjedhura si objekt auditimi janë të lidhura drejtpërdrejtë me politikë-bërjen dhe ofrimin e shërbimeve për realizimin e mekanizmave të parashikuar për zhvillimin e këtij programi. Konkretisht:

➤ **Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural (MBZHR);**

MBZHR koncepton dhe zbaton politikat e përgjithshme shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Misioni i saj është të hartojë dhe zbatojë politika që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, të hartojë dhe të përafrojë legjislacionin në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural, të mbledhë e të përpunojë informacionin bujqësor, të ofrojë asistencë dhe informacion për fermerët. Për një administrim sa më të mirë të këtij programi, pranë MBZHR krijohet me urdhër të ministrit, sekretariati teknik i cili kryen detyra ndihmëse dhe administrative për Komisionin Ndërmnistror për Programin e 100 Fshatrave.

MBZHR, në rolin e sekretariatit teknik kryen këto detyra:

- ✓ Përgjigjet për organizimin dhe për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit;
- ✓ Përgatit materiale dhe raporte me shkrim për ecurinë e zbatimit të programit;
- ✓ Informon dhe koordinon punën me institucionet publike, bashkitë, agjencitë zbatuese, si dhe me partnerë të tjerë, në zbatim të detyrave të përcaktuara nga komisioni;
- ✓ Kujdeset për administrimin e faqes së internetit të programit të 100 fshatrave;
- ✓ Kujdeset për informimin publik dhe transparencën e programit të 100 fshatrave;
- ✓ Ky sekretariat kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga komisioni.ö.

- **Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR);**

AZHBR, është person juridik publik në varësi administrative të MBZHR, është institucion buxhetor dhe ushtron aktivitetin e saj duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas. Kjo agjenci zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Objekti i veprimtarisë së AZHBR^{së} është implementimi i masave të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural. Hartimi i raporteve dhe analizave në përputhje me zhvillimin bujqësor. Ngritja dhe funksionimi i sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit. Ngritja dhe implementimi i sistemeve të informimit. Krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave. Inspektimi i fermerëve dhe subjekteve që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Misioni i AZHBR-së është zhvillimi agrokulturor dhe rural në Shqipëri duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, përgatitja për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Evropian, ristrukturim, modernizim dhe specializim në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit.

➤ **Ministria e Kulturës (MK);**

Ministria e Kulturës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore: ó harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

ó Harton dhe bashkërendon punën për politikat në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, ri jetësimit të vlerave dhe trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal.

ó Harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve.

ó Harton politika për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse.

ó Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarë shqiptar dhe të diversitetit kulturor.

ó Nëpërmjet strukturave të varësisë realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore.

ó Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.

➤ **Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë (MIE);**

MIE ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, përfshirë edhe atë me tubacione për ujësjellës-kanalizimet dhe bashkërendimin e politikave të infrastrukturës së mbetjeve urbane, në komponentin zbatues të tyre, ndjekjen e zbatimin e këtyre politikave në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë jo-ushqimore.

Objektivat për realizimin e misionit të MIE kanë të bëjnë me:

- Drejtimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe vendosjen e standardeve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, tubacioneve, porteve, aeroporteve, ujësjellës-kanalizimeve, vend depozitimeve të mbetjeve dhe digave të mëdha të hidrocentraleve, përcaktimin dhe vendosjen e standardeve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit dhe organizimin e drejtimit të kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit.

- Monitorimin e realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës në transport, ujësjellës-kanalizime, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave, për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar dhe teknik.

- Zhvillimin e hapësirës së nismës së lirë private në aktivitetet e shërbimit të llojeve të transportit, si dhe krijimin e kushteve për një konkurrence të drejtë, ndërmjet llojeve të transportit e zhvillimin e konkurrencës në sistemin e licencimit.

- Drejtimin, përmirësimin, zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve të informacionit në transport dhe infrastrukturë, për sigurimin e burimit të të dhënave të gjithanshme e të vazhdueshme, për krijimin e kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operuesve vendas e të huaj, si dhe të përshtatshme për t'u inkuadruar në sistemet evropiane të informacionit.

- Hartimin dhe zbatimin e politikave në sektorin e energjisë, burimeve energjetike, përfshirë edhe burimet e rinovueshme të energjisë, eficiencën e energjisë dhe ndryshimet klimatike.

- Hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit të sektorit energjetik në vend, përfshirë edhe zhvillimin e infrastrukturës energjetike dhe të linjave të interkoneksionit të energjisë elektrike dhe të gazit, me rajonin dhe në nivel evropian, si dhe bashkërendimi i politikave të energjisë në kuadër të Komunitetit të Energjisë dhe në nivel evropian, përfshirë edhe hartimin e legjislacionit përkatës, në përputhje me acquis komunitare.

- Fushën e planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve energjetike dhe furnizimit të sigurve me energji të sektorëve ekonomike e sociale në vend.

- Monitorimin e realizimit të projekteve, impianteve dhe instalimeve të prodhimit dhe transportimit të energjisë elektrike, të naftës dhe gazit, referuar standardeve në fuqi, duke garantuar realizimin me eficiencë të lartë të investimeve në fushën e energjisë,

- Garantimin e standardeve bashkëkohore në aktivitetin e kërkimit, prodhimit dhe përpunimit të burimeve energjetike hidrokarbure, për një shfrytëzim sa më eficient të tyre dhe në interes të ekonomisë vendase, si dhe zhvillimin e një tregu energjie të diversifikuar, të liberalizuar dhe konkurrues, në të cilin shteti të luajë rolin e tij rregullator.

- Hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit të sektorit të telekomunikacioneve në vend, përfshirë zhvillimin e infrastrukturës broad-band, si dhe hartimin e legjislacionit përkatës, në përputhje me acquies komunitare.

- Hartimin dhe propozimin e Planit Kombëtar të Frekuencave, në përputhje me Radio Rregulloret e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve dhe Planin Evropian të Alokimeve.

- Hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit të sektorit postar në vend, si dhe hartimin e legjislacionit përkatës, në përputhje me acquies komunitare.

➤ **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT);**

AKPT është autoritet me përgjegjësi planifikimi, në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit (aktualisht MIE). Misioni i saj është të kontribuojë për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të udhëhequr nga strategjitë e mirë planifikuara dhe programet afatmesme e afatgjata të zhvillimit; të sigurojë zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi që garantojnë mirë planifikimin e territorit si edhe të mbështesë dialogun profesional në fushën e planifikimit të territorit, duke përhapur njohuritë e fituara gjatë eksperiencës në këtë fushë.

AKPT është përgjegjëse për:

- informimin e proceseve të përmirësimit të legjislacionit të planifikimit të territorit;

- administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të planifikimit të territorit;

- informimin e publikut për proceset e planifikimit të territorit, si dhe për nxitjen e pjesëmarrjes së tij gjatë proceseve të hartimit e zbatimit të dokumenteve të planifikimit;

- sigurimin e standardeve ligjore, teknike dhe metodologjike të fushës së planifikimit të territorit;

- përgatitjen e studimeve për Sistemin e Integruar të Planifikimit në Republikën e Shqipërisë dhe propozimet për ministrin përgjegjës për planifikimi dhe zhvillimin e territorit, Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Këshillin e Ministrave, për masat për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe për procese e veprimtari në lidhje me planifikimin e territorit;

- hartimin e Raportit Vjetor Monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave, të deklaruara në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare;

- hartimin e modeleve të zhvillimit për secilin prej 100 + fshatrave dhe që kryhen në zbatim të Programit Kombëtar të Zhvillimit Rural;

- miraton serinë e aktiviteteve të organizimit të nismës òAkademia 100 + fshatratò me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

➤ **Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit (MTM);**

MTM, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe zbatimin e politikave për turizmin.

MTM e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha të përgjegjësisë shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

- Sektorin e mjedisit, përfshirë politikat, standardet e trajtimit të mbetjeve dhe të efekteve që sjellin në drejtim të ajrit dhe mjedisit, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujërave, vlerësimin e ndikimit në mjedis.
- Natyrën dhe biodiversitetin, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura.
- Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave.
- Harton dhe zbaton politika për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, ngritjes dhe monitorimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit në vazhdim të biznesit në fushën e turizmit, promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor dhe funksione të tjera, të cilat do të mbulojnë nga institucionet e varësisë, aparati i ministrisë dhe degët territoriale.

Ministritë pjesëmarrëse në program caktojnë personat e tyre të kontaktit (në nivel drejtuesi të ministrisë), që janë ura lidhëse ndërmjet sekretariatit teknik dhe ministrive përkatëse⁴ si dhe ofrojnë mbështetje për organizimin e serisë së aktiviteteve të nismës òAkademia 100 + fshatrat⁵:

2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjen nën auditim.

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjektit lidhur me çështjen nën auditim që do të jetë burimi i kriterëve të auditimit.

- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillim Rural dhe Bujqësor 2014-2020;
- Ligji nr. 9817 datë 22.07.2007, òPër bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- Ligji nr. 3/2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar, neni 6.
- VKM nr. 719 datë 31.10.2014, òPër organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si Agjenci e Pagesave;
- VKM nr. 137 datë 22.02.2017, òPër përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2017;
- VKM nr. 22, datë 12.1.2018 òPër miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij.
- VKM nr. 72, datë 07.02.2018, òPër përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2018;
- VKM nr. 546, datë 19.09.2018, òPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 72, datë 07.02.2018, òPër përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2018, të ndryshuar;
- VKM nr. 128, datë 13.03.2019, òPër përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019;

⁴ Vendim nr.21, datë 12.1.2018 për disa shtesa në Vendimin nr.709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, òPër miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020

⁵ Vendim nr. 492, datë 26.7.2018 për miratimin e mënyrës së rregullimit të aktiviteteve të nismës òAkademia 100 + fshatrat

- VKM nr. 184, datë 04.04.2019, òPër disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 128, datë 13.03.2019, òPër përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019ò;
- VKM nr. 100, datë 05.02.2020, òPër përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2020ò;
- VKM nr. 1102, datë 24.12.2020, òPër përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2021ò;
- VKM nr.537, datë 08.07.2020, òPër miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementëve të ndërtesaveò;
- VKM nr.934, datë 25.11.2020, òPër miratimin e kriterëve dhe të procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesaò;
- VKM nr.958, datë 02.12.2020, òPër miratimin e kushteve të certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes e kushteve të regjistrimit të òcertifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave.ò;
- VKM nr.256, datë 27.3.2020, òPër miratimin e metodologjisë për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, të njëjësive dhe të elementeve të ndërtesaveò.
- VKM nr.492, datë 26.7.2018, òPër miratimin e mënyrës së rregullimit të aktiviteteve të nismës ò Akademia 100+ fshatrato, në zbatim të programit kombëtar të zhvillimit rural me fokus 100+ fshatrato.
- Urdhër nr. 311, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, datë 09.09.2019, për òMiratimin e rregullores mbi funksionimin e Komisionit vlerësues të certifikimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i certifikatës paraprake ò, i ndryshuar me Urdhrin nr.32, datë 26.01.2021;
- Urdhër nr. 312, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, datë 09.09.2019 për òMiratimin e modelit të certifikatës paraprake, certifikatës òSubjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmitò dhe shenjës dallueseò;
- Urdhër nr. 323, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, datë 18.09.2019, për òNgritjen e komisionit të vlerësimit òCertifikatë paraprake për veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëmò dhe certifikatë òSubjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmitò;
- Udhëzim nr. 8, i përbashkët, i MBZHR dhe MFE, datë 31.03.2017, òPër procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò;
- Udhëzim nr. 10, datë 22.05.2017, òPër disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin, nr. 8, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 31.03.2017, òPër procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò;
- Udhëzim nr. 1, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 19.02.2018, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò;
- Udhëzim nr. 11, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 21.06.2018, òPër disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 1, datë 19.02.2018, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò;
- Udhëzim nr.14, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 28.09.2018, òPër disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 1, datë 19.02.2018, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò, i ndryshuar;

- Udhëzim nr.3/1, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 15.04.2019, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò;
- Udhëzim nr.5, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 07.06.2019, òPër një ndryshim në Udhëzimin nr. 3/1 datë 15.04.2019, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò;
- Udhëzim nr.3, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 24.02.2020, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò;
- Udhëzim nr.3/1, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 12.03.2020, òPër disa ndryshime në Udhëzimin nr 3, datë 24.02.2020, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò;
- Udhëzim nr.3/2, i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 13.05.2020, òPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 24.02.2020, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò, të ndryshuar;
- Udhëzim nr.3/3 i përbashkët i MBZHR dhe MFE, datë 08.09.2020, òPër disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 24.02.2020, òPër kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin ruralò, të ndryshuar;
- UKM nr.3, datë 15.2.2001, òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar.
- Urdhër i përbashkët i Ministrít të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrít të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr. 32 datë 26.01.2021, òPër miratimin e rregullores mbi funksionimin e komisionit vlerësues të certifikimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar, si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i certifikatës paraprake apo i certifikatësò;
- Rregullore e Brendshme e AZHBR- 2019,nr. 97/1 prot. datë 21.02.2019, miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Rregullore e Brendshme e AZHBR, 2020, Udhëzim i Ministrít të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr. 13, datë 05.10.2020, botuar në fletoren zyrtare nr. 178/2020;
- Raporte vjetore të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural;
- Raporte nga organizata ndërkombëtare (GIZ, S G, FAO);
- PBA për çdo ministri.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.

Përfitues nga Programi i 100 fshatrave janë popullsia e zonave rurale, fermerët dhe grupet e fermerëve, individë, në veçanti gratë dhe të rinjtë, persona juridikë, bashkitë, organizatat jofitimprurëse, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, etj.

Programi i Integruar për Zhvillimin Rural, do të programojë ndërhyrjet me investime të integruara në zonat e përcaktuara (100 fshatra), nëpërmjet 3 objektivave, si më poshtë vijon:

- a) Përmirësimi i infrastrukturës publike;
- b) Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike;
- c) Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor.

Në kuadër të këtij programi janë identifikuar 3 projekte strategjike të cilat duhet të zbatohen me prioritet të lartë:

i) Krijimi i rrjetit të agroturizmit shqiptar

Agroturizmi dhe turizmi rural janë veprimtari të cilat kanë një potencial të lartë zhvillimi për zonat rurale në Shqipëri dhe tashmë në shumë fshatra të Shqipërisë kanë filluar të funksionojnë ferma që ofrojnë shërbime në agroturizëm. Në kuadër të programit të 100 fshatrave do të mbështetet me instrumente financiare dhe fiskale krijimi i një rrjeti fermash

agroturistike, që plotësojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara, të cilat do të jenë baza e rrjetit shqiptar të agroturizmit. Mbështetja për të krijuar një masë kritike të numrit të sipërmarrjeve të agroturizmit në Shqipëri do të shërbejë për rritjen e punësimit në zonat rurale, krijimin e një destinacioni dhe òmarkeò të veçantë të agroturizmit në Shqipëri, krahas ofertave të tjera turistike, si dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe vlerave tradicionale të fshatit shqiptar. Programi do të synojë mbështetje për rreth 27 sipërmarrje agroturizmi të reja dhe 150 bujtina. Mbështetja do të synojë, gjithashtu, edhe përmirësimin e fermave dhe staneve blegtorale për qëllime të veprimtarisë së agroturizmit dhe turizmit rural.

ii) Rrjeti i inkubatorëve të produkteve tradicionale

Shqipëria ka potenciale të mëdha dhe të shumta në prodhimin e produkteve ushqimore tradicionale. Produktet tradicionale shqiptare të prodhuara në mënyra artizanale, pavarësisht nga vlerat e mëdha dhe të interesit të konsumatorit vendës dhe të huaj, kanë treguar që depërtojnë me vështirësi në tregje për shkak të shkallës së vogël ekonomike që rrisin kostot për njësi të prodhimit, sasive të limituara të prodhimit, si dhe të kërkesave të larta ligjore për standardet e ushqimit dhe ato higjieno-sanitare. Programi do të synojë të krijojë rrjetin e inkubatorëve të produkteve tradicionale, që do të jenë hapësira që ofrojnë infrastrukturë të gatshme për të gjithë zinxhirin e vlerës së produktit, duke filluar që nga ambientet dhe pajisjet e prodhimit/magazinit, linjave të paketimit dhe të marketimit, mbështetje për standardizimin e certifikimit, si dhe hapësirë për shitje të produkteve. Inkubatorët do të ofrojnë mbështetje për prodhuesit e vegjël të zonave rurale, në veçanti grave dhe të rinjve, të cilët mund të shfrytëzojnë inkubatorin për prodhimin, paketimin, marketimin, standardizimin dhe shitjen e produkteve të tyre, kundrejt një pagese të lehtësuar dhe të përballueshme për shërbimet që ofron inkubatori.

iii) Rrjeti i markatave/dyqaneve të produkteve shqiptare dhe tradicionale

Produktet tradicionale shqiptare kanë treguar që e kanë të vështirë depërtimin në tregjet dhe dyqanet e shitjes me pakicë, për shkaqet e shpjeguara në nënpikën ôiiò. Në mbështetje të hallkës së fundit të zinxhirit të vlerës (shitja), programi do të synojë që të krijojë një rrjet të markatave/dyqaneve që do të jenë të specializuara në shitjen e produkteve shqiptare, në veçanti produkteve tradicionale. Do të synohet që ky rrjet të ketë emërtimin e tij (markën/brand-in) që e dallon nga rrjetet e tjera dhe bazuar në një strategji të posaçme marketingu dhe franchise, do të mund të krijojë një masë kritike të dyqaneve që do të bëjnë të mundur rritjen e përqindjes së shitjes së produkteve shqiptare/tradicionale. Mbështetja financiare për ngritjen e këtij rrjeti do të parashikohet në kuadrin e programit të 100 fshatrave.

I gjithë aktiviteti i subjekteve për zhvillimin e programit, duhet të përkthehet në produkte specifike dhe infrastrukturë funksionale e bashkëkohore, që të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes së agroturizmit, turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore me potenciale të larta zhvillimi ekonomiko-sociale.

2.4 Pesha në buxhet.

Programi i 100 fshatrave mund të financohet nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në program. Në detajimin e fondeve për investime, të alokuara në buxhetet respektive të ministrive apo të institucioneve të tyre të varësisë, ministritë pjesëmarrëse në program do të synojnë t'u japin përparësi projekteve të identifikuar dhe që zbatohen në zonën e përcaktuar të 100 fshatrave.

Projektet e identifikuar në kuadër të programit të 100 fshatrave, mund të financohen edhe nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve. Ministritë pjesëmarrëse mund të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për grante, për financimin e këtij programi nga donatorë dhe me financim të

huaj. Programi mund të financohet nga çdo burim tjetër i ligjshëm apo nëpërmjet mekanizmave të partneritetit publik privat.

Nga faza studimore në terren ka rezultuar se MIE, MK dhe MBZHR, nuk kanë pasur fonde në dispozicion për këtë program. Sipas ministrive dhe agjencive rezulton se shpenzimet e kryera kanë kaluar në kode programi të ndryshme.

Shpenzimet faktike të kryera sipas ministrive dhe agjencive për të cilat është kryer faza studimore në terren paraqiten:

Subjektet	Plani përfundimtar	Fakti
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	72,464,148	72,395,032
Ministria e Kulturës	0	0
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore	11,365,241	11,365,241
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Bujqësor	0	0
Agjencia e Zhvillimit Bujqësor e Rural	93,406,445	83,857,879
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës	0	0
AKPT	31,200,000	24,412,000
Totali	208,435,834	192,030,152

Burimi: MBZHR, MTM, MK, MIE, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

❖ Theksojmë se shpenzimet e sipërpërmendura në grafik nuk kanë kodin e programit 04230, por kanë kode të ndryshme. Këto shpenzime të kryera planin përfundimtar të buxhetit e kanë pasur 208,435,834 lekë dhe janë realizuar në masën 92%.

2.5 Feedback-u i subjektit përgjatë gjithë auditimit.

Gjatë auditimit, subjektet, Ministria e Kulturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit si dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikes, AKPT dhe AZHBR, janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi t'ia trajtonte. Nga informacioni i kërkuar, u vendos në dispozicion kryesisht dokumentacioni që lidhet me bazën ligjore, historikun, strukturën e subjekteve, etj. Subjektet AKPT dhe AZHBR kanë kërkuar njoftim fillim auditimi më vete pavarësisht se ishin njoftuar nëpërmjet ministrive të linjës prej të cilave janë në varësi, fakt i cili ka vonuar procesin e auditimit në terren. Në përgjithësi, subjektet e mësipërme i janë përgjigjur në kohë takimeve konsultuese, por përgjigjet e pyetësorëve janë vonuar dhe nuk kanë qenë të plota, fakt i cili tregoi një mungesë koordinimi në realizimin e këtij programi.

Pas këmbënguljes së grupit të auditimit, informacioni i kërkuar, në shumë raste i mangët nga ana e MIE, MBZHR, MK, MTM, AKPT, u dërgua në format elektronik.

III. DETAJET E AUDITIMIT.

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.

Risqet e aktivitetit të subjektit nën auditim janë ato me të cilat përballen aktorët e përfshirë në arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave e funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, për realizimin e përgjegjësi që krijohen nga aktiviteti në tërësi duke u fokusuar në politikën, programet, proceset dhe strategjitë që ndjekin këto institucione për zhvillimin e programit të integruar të 100 fshatrave. Risqet e aktiviteteve të subjektit mbartin me vete disa problematika, ku më kryesoret janë hartimi dhe zbatimi i politikave, strategjive nga institucionet përgjegjëse, ngritja e strukturave monitoruese, ndërveprimi institucional, parashikimi i instrumenteve financiare.

Risqet e aktiviteteve të subjektit nën auditim kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që institucioni has në arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave e funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë auditim, analiza e riskut është mbështetur në identifikimin e risqeve sipas 6 elementëve të analizës si më poshtë:

Tabela nr.1

Op/ Str	Përshkrimi i Riskut	Niveli i Riskut	Pyetja e Auditimit	Efektet që mund të kenë risqet e identifikuar	Realizueshmëria
Strategjik	Mungesa e ndarjes së detyrave të përcaktuara për ministrinë e përfshira në program. Mungesa e Planeve të punës. Mungesa e përcaktimit të objektivave për realizimin e programit.	L	A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e programit 100 fshatrat?	Mos detajimi i detyrimeve të përcaktuara në strategji apo mos hartimi i politikave të duhura ndikon në menaxhim jo të mirë për përfitimin e modeleve të zhvillimit ekonomik për secilin prej fshatrave me ndikim në social-ekonomik.	Vështirë
	Mungesa e një plani veprimi me indikatorë të matshëm dhe afate të mirë përcaktuara; Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit mes aktorëve përgjegjës për finalizimin e projektit; Shtrirja e gjerë territoriale e projektit; Mungesa e monitorimit në të gjitha dimensionet e projektit.	L	A janë arritur objektivat e përcaktuara në Strategji (PIZHR), programi 100 fshatrave?	Mos bashkëpunimi/koordinimi i strukturave përgjegjëse, mungesa në mjete logjistike dhe burime njerëzore, sjell që misioni i inspektimeve të mos realizohet, të favorizohet aktiviteti i paligjshëm, të gjitha këto kanë ndikim të drejtpërdrejtë, në të ardhurat e pritshme nga zhvillimi i zonave rurale dhe agroturizmi.	Vështirë
Operacionale	Mund të mos jetë siguruar mbështetja financiare e përshkruar në Strategjinë Kombëtare të MBZHR	L	A janë marrë masat e duhura për të mbuluar me financim programin 100 fshatrat, me qëllim arritjen e objektivave?	Mungesa e mbështetjes financiare nga buxheti i ministrive të përfshira në program do të bënte të vështirë ose të pamundur arritjen e objektivave të përcaktuara në PIZHR dhe si rezultat nuk do të realizohej synimi kryesor i zhvillimit të kësaj strategjie, zhvillimi i 3 objektivave strategjik.	Vështirë
	Procesi i ndjekur për realizimin e programit mund të mos jetë efektiv.	L	A kanë ndikuar procedurat e ndjekura nga strukturat MTM, AKPT, AZHBR për realizimin e programit?	Ndikon në mos zhvillimin e produktit turistik dhe në mos zhvillimin e atraksioneve kryesore natyrore me funksion edukativ dhe informues	Vështirë

3.2 Objektivat e auditimit.


Objektivi kryesor i auditimit është vlerësimi mbi efektivitetin e politikave të zbatimit të programit të integruar për 100 fshatrat si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor. Për të përmbushur objektivin kryesor grupi i auditimit do të vlerësojë:

- *Kuadrin ligjor që rregullon programin e qeverisë për 100 fshatrat, nëse ai është i plotë, i përditësuar dhe nëse zbatohet me rigozitet nga strukturat përgjegjëse;*
- *Organizimin e duhur strukturor (ngritja e strukturave) për zbatimin e strategjisë për PIZHR;*
- *Mbështetjen financiare që ka shkuar për të realizuar programin dhe përmirësuar infrastrukturën për realizimin e objektivave strategjik;*
- *Bashkëveprimin midis strukturave përgjegjëse dhe monitorimin e realizimit të indikatorëve me qëllim rritjen e efektivitetit të programit.*

Grupi i auditimit nëpërmjet analizës së veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse dhe vlerësimit të fushave të sipër cituara, do të përpiqet të evidentojë problematikat që kanë ndikuar në zbatimin e programit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime për përmirësime të mëtejshme.

3.3 Pyetjet e auditimit

Skema nr.1, “Piramida e pyetjeve të auditimit”.



3.4 Fushëveprimi i auditimit.

Për të vlerësuar performancën e efektivitetit të programit të integruar për zhvillimin rural-
ōProgrami i 100 fshatraveō, referuar analizimit të të dhënave dhe medias së shkruar auditimi
u shtri në institucionet si më poshtë:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Ministria e Kulturës;
4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
5. Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural;
6. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Auditimi synoi vlerësimin e disa aspekteve të implementimit të ōProgramit të 100 fshatraveō,
si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor sikurse janë, kuadri ligjor (dalja e VKM),
ngitja e strukturave përgjegjëse, koordinimi i aktorëve të përfshirë, mbështetja financiare,
investimet si dhe efektet e pritura.

Gjatë fazës së kryerjes së auditimit grupi i auditimit kreu vizita dhe verifikime në terren, në
fshatra të përfshirë në lote të ndryshme duke marrë si fokus shtrirjen në të gjithë territorin,
nga veriu në jug si dhe në Shqipërinë e mesme.

Periudha e mbulimit me auditim përfshin datën e fillimit të projektit deri më 31.03.2022.

IV. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

Në përfundim të realizimit të programit të auditimit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MTM, MK, MIE, MBZHR, ABZHR, AKPT mbi veprimtarinë e tyre për realizimin e PIZHR, si dhe nga verifikimet dhe takimet në zonat e përfshira në 100 fshatrat, u arrit në këtë **mesazh auditimi**:

MESAZHI I AUDITIMIT

oProgrami i integruar për 100 fshatrat, projekt i cili do të çonte nivelin e turizmit dhe promovime të tjera të tyre, është konkretizuar pjesërisht me sistemimin e zonave/fshatrave, por ende ka punë për të bërë në drejtim të organizimit dhe bashkërendimit të punës mes njësisve përgjegjëse për ndjekjen dhe monitorimin e këtij programi, konkretisht:

- Nuk ka një rezultat gjithëpërfshirës mbi shkallën e realizimit të objektivave specifike të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020 (*këtu: Strategjia*), si dhe shkallën e përmbushjes së indikatorëve/impaktit që synon të arrijë ky program siç janë rritja e numrit të vendeve të punës; numrit të të punësuarve gra/vajza; dhe të rinj; numrit të bizneseve start-up, të bujtinave; të inkubatorëve për produkte tradicionale; numrit të sipërmarrjeve të reja të agroturizmit; numrit të sipërmarrjeve prodhuese të produkteve tradicionale; si dhe numrit të projekteve të realizuara të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

- Nuk është dokumentuar aktiviteti dhe përbërja e Komisionit Ndërministror, i cili duhet të vendoste për ecurinë e programit dhe nuk rezulton të jetë ngritur as Sekretariati Teknik për të mbështetur Komisionin. Për zbatimin e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) ó Programi i 100 fshatrave, si pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, nga ana e ministrive përgjegjëse nuk u krijuan struktura të posaçme, të cilat do të mundësonin administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e programit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve. Ky program nuk është zbërthyer më tej në plane vjetore pune; si pasojë kanë munguar raportet e monitorimit për të ndjekur ecurinë e projektit në mënyrë të koordinuar.

- Edhe pse këtij projekti i është dedikuar një program buxhetor specifik, konstatuam përdorimin e programeve të tjera buxhetore nga ana e subjekteve, për fonde që lidhen me Programin e 100 fshatrave, duke bërë të vështirë gjurmimin e shpenzimeve për këtë program nga pikëpamja e zbatimit të buxhetit.

PYETJA KRYESORE - A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e “Programit 100 Fshatrat”?

Konteksti i Zhvillimit Rural, është element i rëndësishëm i politikave zhvillimore të një vendi dhe pjesë komplementare përkrah politikave të bujqësisë. Në hapësirën e vendeve të BE-së, zhvillimi rural bën pjesë në Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) dhe konsiderohet si shtylla e II e kësaj politike. Zhvillimi rural konsideron integrimin e instrumenteve të zhvillimit të hapësirës rurale përtej (dhe jo vetëm) bujqësisë dhe që lidhen ngushtë me zhvillimin e infrastrukturës, riverifikimin ekonomik, ruajtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore si dhe e fundit por jo nga rëndësia, zhvillimin e kapitalit social dhe njerëzor.

Programi qeverisës 2017-2021, synonte t’i përgjigjej pikërisht këtij konteksti zhvillimi të vendit si dhe të adresonte sfidat me të cilat përballlet sot fshati dhe hapësira rurale, nëpërmjet krijimit të një programi të posaçëm kombëtar oProgrami i Integruar për Zhvillimin Rural ó oProgrami i 100 fshatrave, krahas programeve dhe projekteve të tjera të financuara nga BE-ja dhe donatorë të tjerë.

Konceptimi i termit ÷zhvillim ekonomik⁶ përshkon një proces, që ka kohëzgjatje dhe vazhdimësi të gjatë, i cili nuk mund të arrihet për 5 ose 10 vite, por arrihet duke përmbushur premisat ekonomike dhe shoqërore, duke ndikuar në jetën e çdo personi të atij vendi, pra koncepti bazë i zhvillimit ekonomik është se nuk ka periudhë se kur mund të arrihet, dhe varet prej shumë faktorëve ndikues dhe përcaktues në arritje të zhvillimit ekonomik.

Termi ÷Zhvillim, nënkupton procesin e kalimit nga shkalla më e ulët në shkallën më të lartë, dhe duke ja bashkangjitur fjalën ekonomi, që përfshin fusha të ndryshme jetësore, si: bujqësia, arsimit, teknologjia, industria, shoqëria, e tjera, konkludojmë që termi ÷Zhvillim ekonomik, nënkupton arritjen e një shkalle të lartë në të gjitha fushat e jetës së njeriut, e jo vetëm të sektorit ekonomik.

Programi i Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) ó ÷Programi i 100 fshatrave (ose në vazhdim Programi ÷100 fshatrave) ka nisur me ngritjen e Urdhrit të Përbashkët nr. 538, datë 12.12.2017 ÷Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Programit të Zhvillimit të Integruar Rural ó ÷Programit të 100 fshatrave, i firmosur nga ministrat përkatës të Ministrive të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Turizmit dhe Mjedisit, Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Kulturës.

IV.1 A janë arritur objektivat e përcaktuara në Strategji (PIZHR), “Programi i 100 fshatrave”?

IV.1.1 A i ka shërbyer koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional, përmbushjes me sukses të objektivave/detyrimeve që burojnë nga Strategjia?

÷Programi i 100 fshatrave, është iniciativë e përbashkët 4 ministrive të linjës⁷ dhe referuar VKM nr.21, datë 12.1.2018 për disa shtesa në Vendimin nr.709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, ÷Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, MBZHR, duhet të udhëheqë zhvillimin e integruar të zonave rurale duke mbështetur ÷modele zhvillimi në hapësirën e 100 fshatrave, që mund të zbatohen edhe në zona dhe fshatra të tjerë.

Qëllimi i këtij programi ka qenë mbështetja e ekonomisë jobujqësore dhe kthimi i këtyre fshatrave në zona turistike, bazuar kjo në potencialin e tyre turistik, duke ndërhyrë në infrastrukturë, përfshi rrugë, sheshe, kanalizime, ujësjellës, rehabilitim objektesh kulturore apo objektesh të trashëgimisë historike.

Efektet kryesore që pritet të sjellë ky program, janë kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, diversifikimit ekonomik nëpërmjet turizmit, rritjes së numrit të turistëve, bizneseve dhe punësimit, rritje të mundësive për arsim profesional dhe trajnim për fermerët dhe banorët e zonave rurale.⁸

Bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020, që i bashkëlidhet VKM nr. 21, datë 12.1.2018, ÷Për disa shtesa në VKM nr. 709, datë 29.10.2014, ÷Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020, për zbatimin e këtij programi, bazuar në qasjen ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, do të krijohen struktura të posaçme, të cilat do të bëjnë të mundur administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e programit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve dhe të autoritetit përkatës. Në këtë VKM është përcaktuar edhe impakti i përgjithshëm (indiktorët) që synon të arrijë PIZHR, i cili do të matet me treguesit e matshëm.

⁶ https://www.academia.edu/12256835/Konceptet_baz%C3%AB_t%C3%AB_zhvillimit_ekonomik?email_örork_card=vieë-paper

⁷ Sipas Urdhrit nr.538, datë 12.12.2017 për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e programit të zhvillimit të integruar rural ÷Programi i 100 fshatrave.

⁸ R e l a c i o n - Për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave ÷Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 29.10.2014 ÷Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural dhe Bujqësor 2014-2020

Për sa më sipër, për administrimin e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) ó Programi i 100 fshatraveó, është krijuar Komisioni Ndërmintor për óProgramin e 100 fshatraveó, me përbërje të: (i) Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, (ii) Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, (iii) Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe (iv) Ministrit të Kulturës.

Gjetje nga auditimi:

1. Institucionet objekt auditimi, MBZHR, MTM, MIE dhe MK, edhe pse janë pjesë e Komisionit Ndërmintor për óProgramin e 100 fshatraveó, i cili do të administrojë programin, nuk disponojnë asnjë dokument strategjik, apo raporte monitorimi, relacione, vendime, udhëzime, analiza ose studime që lidhen me zhvillimin e këtij programi.

2. MBZHR, MTM, MIE dhe MK, nuk disponojnë plane pune vjetore të hartuara për periudhën e zbatimit të programit qeveritar për 100 fshatrat (2018-2021).

3. Për të përmirësuar performancën ekonomike dhe kushtet e jetesës në zonat rurale, referuar aktit nënligjor që lidhen me strategjinë, ky program ishte planifikuar të përfundonte në vitin 2020. Pavarësisht se në strategji janë përcaktuar indikatorë të matshëm, ato nuk janë zbërthyer sipas aktit nënligjor. Nuk ka të dhëna se sa kanë qenë përpara fillimit të programit këta indikatorë dhe sa janë realizuar mbas përfundimit të afatit kohor. Edhe pse kanë kaluar dy vjet nga afati i përfundimit, ky program vijon të jetë në hapat e tij fillestar, duke lënë jashtë monitorimit indikatorët që synojnë përmirësimin e performancës ekonomike dhe kushtet e jetesës në zonat rurale.

Referuar aktit nënligjor, brenda afatit kohor 2018-2020, duhet të ishin përmbushur këto objektiva:

- Përmirësimi i infrastrukturës publike;
- Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike;
- Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor

4. Afati 3 vjeçar i zbatimit të programit, nuk është në përputhje të plotë me vetë termin e óZhvillimit ekonomikó, pasi konceptimi i këtij termi nënkupton procese që kërkojnë kohë më të gjatë

Konkluzione:

1. Edhe pse afati për realizimin e këtij programi ka përfunduar, nuk ka një rezultat gjithë përfshirës mbi shkallën e realizimit të objektivave specifike të parashikuara në Strategji si dhe shkallën e përmbushjes së indikatorëve/impaktit që synon të arrijë PIZHR.

Rekomandime:

1. MBZHR, në cilësinë e drejtueses së Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Rural, MTM, MIE dhe MK si dhe agjencitë e tyre në varësi, të cilat kanë lidhje me óProgramin e 100 fshatraveó, të marrin masa të menjëhershme për të rivendosur në afat objektivat, me qëllim realizimin e këtij programi.

2. MBZHR, MTM, MIE dhe MK, si dhe agjencitë e tyre në varësi, të cilat kanë lidhje me óProgramin e 100 fshatraveó, të marrin masa për të ngritur grupe pune për administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e óProgramit të 100 fshatraveó, sipas ndarjes së qartë të roleve dhe të autoritetit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar MBZHR, është paraqitur komenti me nr. 2079/05 prot., datë 27.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/15, datë 28.07.2022, ku janë shprehur komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për gjetjen **nr.1, 2, 3**, ku komentohet se: Ekziston baza ligjore përkatëse, ndryshimi i VKM nr. 709,

datë 29.10.22 si dhe VKM dhe udhëzime të përbashkëta. Për sa kohë procesi i kaloi koordinatori kombëtar dhe nuk pati fonde të dedikuara për MBZHR, nuk u hartuan plane vjetore pune për këtë qëllim. Kanë ndikuar tërmeti dhe situata pandemike Covid 19 si dhe përthithja e fondeve nga FSHZH, zhvendosën rolin nga MBZHR drejt Kryeministrit dhe zbatimin/financimin e projekteve nga MBZHR tek FSHZH.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar baza ligjore e cituar i përket strategjisë tuaj. Edhe pse afati për realizimin e këtij programi ka përfunduar, nuk ka një rezultat gjithë përfshirës mbi shkallën e realizimit të objektivave specifike të parashikuara në Strategji si dhe shkallën e përmbushjes së indikatorëve/impaktit që synon të arrijë PIZHR. Ju nuk keni një dokument që procesi i ka kaluar koordinatorit kombëtar.

Gjetje nga auditimi:

5. Nga ana e MBZHR, MTM, MIE dhe MK, nuk janë ngritur strukturat e posaçme të cilat do të bënin të mundur administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e Programit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve dhe të autoritetit përkatës; për rrjedhojë nuk ka as monitorim të punës së kryer nga ana e tyre.

6. Nuk rezulton dokumentimi i aktivitetit si dhe pjesëmarrja e Komisionit Ndërmintor, i cili duhet të vendoste për ecurinë e programit. Si pasojë, nuk ka të dhëna as mbi vendimet e marra nga ana e këtij Komisioni në lidhje me çështjet që lidhen me administrimin, programimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e Programit të 100 fshatrave, si p.sh.: sa projekt ide janë administruar në Komision dhe sa nga to janë miratuar; si edhe sa bashkëpunime ka me bashkitë dhe agjencitë rajonale të zhvillimit, si dhe me partnerë të tjerë publikë apo privatë, që janë të interesuar për të mbështetur Programin e 100 fshatrave.

7. Në MBZHR, nuk është ngritur Sekretariati Teknik për të mbështetur Komisionin, sipas aktit nënligjor.

8. Gjithashtu, në ministritë pjesëmarrëse në program (subjekt i këtij auditimi) nuk ka të dhëna mbi personat e kontaktit (në nivel drejtuesi të ministritë përkatëse), që do të shërbenin si ura lidhëse ndërmjet Sekretariatit Teknik dhe ministrive përkatëse. Në fillim të procesit për hartimin e PIZHR, katër ministrat përkatës kanë caktuar personat e kontaktit, në nivel këshilltari të kabineteve të tyre, të cilët pasi janë larguar nga detyra, nuk janë zëvendësuar dhe as nuk kanë bërë dorëzim detyre. Roli i sekretariatit teknik nuk ka qenë aktiv. Mos ngritja dhe si pasojë mosfunksionimi i Sekretariatit Teknik shoqërohet me mungesën e dokumentacionit si: raportime periodike nga ministritë në Sekretariat, raporte monitorimi si dhe njëkohësisht mungesën e një data bazë të dhënash (për çdo fshat) mbi gjendjen aktuale të Programit të 100 fshatrave.

Konkluzione:

2. Për zbatimin e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) ó Programi i 100 fshatrave, si pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, nuk u krijuan struktura të posaçme, të cilat do të mundësonin administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e programit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve dhe të autoritetit përkatës, nuk është zbrërthyer më tej në plane vjetore pune. Si pasojë kanë munguar raportet e monitorimit për të ndjekur ecurinë e projektit në mënyrë të koordinuar.

3. Nuk është dokumentuar aktiviteti i Komisionit Ndërmintor, i cili duhet të vendoste për ecurinë e programit.

4. Mosdorëzimi i detyrës si dhe mos përcaktimi i personave përgjegjës për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore cenon gjithë procesin e administrimit të programit qeveritar 100 fshatrat.

Rekomandime:

3. Ministrat e MBZHR, MTM, MIE dhe MK, të bashkëpunojnë në mënyrë intensive duke rivënë në jetë detyrimet e përcaktuara në zbatim të marrëveshjes ndërministrorë të

bashkëpunimit, me qëllim realizimin e synimit kryesor të ÷Programit të 100 fshatraveö, shumë të promovuar në vitet e para të tij (2017-2018).

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Nga ana e MBZHR, të merren masa për të ngritur Sekretariatit Teknik, për një organizim dhe administrim sa më të mirë të këtij programi, duke dokumentuar punën e Komisionit dhe përgatitjen e materialeve për ecurinë e zbatimit të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. MBZHR, MTM, MIE dhe MK, të marrin masa për të caktuar personat e kontaktit, në nivele drejtues, që do të shërbejnë si ura lidhëse ndërmjet Sekretariatit Teknik dhe ministrive përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. MBZHR, MTM, MIE dhe MK, të marrin masa për krijimin e një data bazë mbi punën e dedikuar të kryer për ÷Programin e 100 fshatraveö, për të bërë të mundur transparencën e programit dhe informimin e publikut.

Brenda vitit 2022

7. Nga ana e Sekretariatit Teknik, i cili do të ngrihet nga MBZHR, të merren masa edhe për informimin dhe koordinimin e punës me institucionet publike, bashkitë, agjencitë zbatuese, si dhe me partnerë të tjerë, për hapjen dhe administrimin e faqes së internetit të ÷Programit të 100 fshatraveö, për informimin publik dhe transparencën e tij, si dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Komisioni.

Në vijimësi

8. MBZHR, MTM, MIE dhe MK, si dhe agjencitë e tyre në varësi, të cilat kanë lidhje direkte me ÷Programin e 100 fshatraveö, të marrin masa të menjëhershme për grumbullimin, inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit që ka lidhje me 100 fshatrat. Në të gjitha rastet në vijim, të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për dorëzimin e dokumentacionit nga punonjësit që largohen nga detyra, përpara dorëzimit të detyrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar MBZHR, është paraqitur komenti me nr. 2079/05 prot., datë 27.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/15, datë 28.07.2022, ku janë shprehur komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për gjetjen **nr.5, 6, 7 dhe 8**, ku komentohet se: Komisioni ndërministror është krijuar nga vetë VKM nr.21, datë 12.01.2018, ka pasur komunikime të vazhdueshme dhe periodike të cilat janë pasqyruar edhe në media, ka pasur proces të ngjeshur bashkëpunimi me AZHR-të për krijimin e databazës, të cilat pas shkrirjes së tyre (4 agjencive) këto projekte janë dorëzuar në FSHZH, et.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa komenti ju bëjmë me dije se për sa trajtoni nuk mbështet në dokumente zyrtare.

IV.1.2 A ka monitoruar MBZHR, në rolin e udhëheqësit të Strategjisë, zbatimin e PIZHR?

Gjetje nga auditimi:

9. MBZHR, si drejtuese e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, nuk ka përfshirë në raportet e monitorimit të kësaj strategjie, ÷Programin e 100 fshatraveö. MBZHR nuk ka kryer monitorime në investimet e kryera në sektorin e agroturizmit nëpërmjet skemës kombëtare për 100 fshatrat.

Konkluzion:

5. Mungesa e monitorimit të strategjisë si dhe monitorimit të investimeve të kryera në sektorin e agroturizmit dhe veçanërisht në lidhje me 100 fshatrat, nuk i mundëson MBZHR

që të krijojë vizion në politikëbërjen në lidhje me strategjinë e zhvillimit të agroturizmit si pjesë integrale e zhvillimit rural si dhe nuk lejon të matet efektiviteti i politikave të ndjekura në realizimin e qëllimit kryesor, atë të zhvillimit rural.

Rekomandime:

9. MZHBR të marrë masa për kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm mbi investimet e kryera në sektorin e agroturizmit, veçanërisht për programin 100 fshatrat, në funksion të realizimit të indikatorëve të përcaktuar në strategjinë e saj.

Menjëherë Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar MBZHR, është paraqitur komenti me nr. 2079/05 prot., datë 27.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/15, datë 28.07.2022, ku janë shprehur komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për gjetjen **nr.9**, ku komentohet se: Strategjia ndërsektoriale nuk ka pasur një plan veprimi. Raportet e monitorimit janë përgatitur bazuar në indikatorët e strategjisë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar ju sqarojmë se nuk është kryer monitorimi i strategjisë si dhe monitorimi i investimeve të kryera në sektorin e agroturizmit dhe veçanërisht në lidhje me 100 fshatrat, fakt i cili nuk i mundëson MBZHR që të krijojë vizion në politikëbërjen në lidhje me strategjinë e zhvillimit të agroturizmit si pjesë integrale e zhvillimit rural si dhe nuk lejon të matet efektiviteti i politikave të ndjekura në realizimin e qëllimit kryesor, atë të zhvillimit rural. Gjithashtu gjatë gjithë periudhës së auditimit ju nuk paraqitët asnjë raport monitorimi në funksion të realizimit të indikatorëve të përcaktuar në strategjinë tuaj.

IV.2 A janë marrë masat e duhura për të mbuluar me financim “Programin e 100 fshatrave”, me qëllim arritjen e objektivave?

IV.2.1 A është siguruar mbështetje financiare nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në program dhe nga mekanizmat e tjerë financiarë?

Referuar VKM nr.21, datë 12.01.2018 Programi i 100 fshatrave, mund të financohet nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në program. Në detajimin e fondeve për investime, të alokuara në buxhetet respektive të ministrive apo të institucioneve të tyre të varësisë, ministrinë pjesëmarrëse në program duhet të synojnë t’u japin përparësi projekteve të identifikuar dhe që zbatohen në zonën e përcaktuar të 100 fshatrave.

Zbatimi i projektvendimit nuk shoqërohet me shpenzime financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Sipas relacionit për projektvendimin e Këshillit të Ministrave Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 29.10.2014 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural dhe Bujqësor 2014-2020, “Programi i 100 fshatrave”, do të financohet brenda tavaneve të parashikuara për investime të 4 ministrive të përfshira në zbatimin e programit. Projektet e identifikuar në kuadër të “Programit të 100 fshatrave”, mund të financohen edhe nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve. Ministrinë pjesëmarrëse mund të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për grante, për financimin e këtij programi nga donatorë dhe me financim të huaj. Programi mund të financohet nga çdo burim tjetër i ligjshëm apo nëpërmjet mekanizmave të partneritetit publik privat”.

Autoriteti Menaxhues i Programit: Për administrimin e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR)- Programi i 100 fshatrave, në bazë të VKM-së, është krijuar Komisioni Ndërmintor për Programin e 100 fshatrave, me përbërje të Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Ministrisë të Kulturës.

Financime te parashikuara në fazën e planifikimit për vitin 2018 – “Programi i 100 fshatrave”.

Në lidhje me parashikimin e financimeve na u paraqit vetëm parashikimi i financimeve për vitin 2018, ndërsa për vitet në vazhdim nuk ka parashikim financimesh.

Nga verifikimet ne sistemin SIFQ, konstatuam se “Programit - 100 fshatrat” i është dedikuar një program buxhetor specifik me kod me kod 04230.

Për vitin 2018, që është edhe viti i parë i zbatimit të programit financimet e parashikuara sipas ministrive, janë si më poshtë⁹:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR): MBZHR kishte parashikuar të vinte në dispozicion të ÷Programit të 100 fshatrave, rreth 300.000.000 lekë, si financime për nxitjen e diversifikimit ekonomik të zonave rurale (objektivi i II i ÷Programit të 100 fshatrave). Këto financime, në përputhje me kuadrin ligjor, kanë qenë të destinuara për fermerët dhe individë të cilët aplikojnë për fonde tek AZHBR:

Mbështetje për bujtinat	50% të vlerës së investimit, por jo më shumë se 15 milion lekë
Mbështetje për fermat e agroturizmit	50% të vlerës së investimit, por jo më shumë se 20 milion lekë
Mbështetje për ambientet e prodhimit të produkteve tradicionale	50% të investimit por jo më shumë se 1 milion lekë.
Mbështetje për makineri dhe pajisje për prodhimin e produkteve tradicionale	50% të vlerës, por jo më shumë se 500 mijë lekë.
Mbështetje për marketingun (përfshirë linjat e ambalazhim/paketimit) e produkteve tradicionale	70% të vlerës, por jo më shumë se 700 mijë lekë.
Mbështetje për (start-up) te rinjtë 22 deri në 35 vjeç	50% të vlerës, por jo më shumë se 500 mijë lekë.
Mbështetje për përmirësimin staneve	80% të vlerës së investimit, por jo më shumë se 200 mijë lekë
Mbështetje për ngritjen e inkubatorëve të produkteve tradicionale	70% të vlerës por jo më shumë se 15 milion lekë.
Mbështetje për dyqanet ÷Konsumo Shqipë	50% të vlerës jo më shumë se 2 milion lekë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE): Në mbështetje të ÷Programit të Integruar për Zhvillimin Rural ó ÷Programi i 100 fshatrave,¹⁰ MIE duhet të vijonte me financim edhe gjatë 2018, të projekteve mbi zhvillimin e territorit të disa prej fshatrave, me katër fusha të ndara si më poshtë:

- 2.1. Projekte që shërbejnë si katalizator i rivitalizimit të qytetit;
- 2.2. Projekte të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- 2.3. Projekte për ujësjellës kanalizimi;
- 2.4. Projekte dhe investime në rrugët nacionale;

Përsa më sipër, nga auditimi rezultoi se, nga MIE nuk ka njësi koordinimi.

Ministria e Kulturës (MK): Në mbështetje të ÷Programit të Integruar për Zhvillimin Rural ó ÷Programi i 100 fshatrave, MK do të financonte gjatë 2018 projektet si vijon.

- a. Trashëgimia materiale - Bashkëjetesë me Natyrën dhe Njerëzit
- b. Trashëgimia jo materiale;
- c. Edukimi përmes kulturës ó programe kulturore;

Përsa më sipër, nga auditimi rezultoi se, nga MK nuk ka asnjë njësi koordinimi apo informacion për të sqaruar në lidhje me ecurinë apo realizimin e këtyre projekteve dhe si kanë ndikuar këto në lidhje me 100 fshatrat, përveç realizimit të restaurimit të dy kishave me fonde të buxhetit të shtetit.

⁹ Burimi i të dhënave për ÷Financime te parashikuara në fazën e planifikimit për vitin 2018 ó ÷Programi i 100 fshatrave, është bazuar në përgjigjet e pyetësorëve të vënë në dispozicion nga MBZHR.

¹⁰ Burimi i të dhënave për ÷Financime te parashikuara në fazën e planifikimit për vitin 2018 ó ÷Programi i 100 fshatrave, është bazuar në përgjigjet e pyetësorëve të vënë në dispozicion nga MBZHR.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM): MTM, në përmbushje të funksioneve të saj dhe në mbështetje të ÷Programit të 100 fshatrave, kishte parashikuar dy tipe ndërhyrjesh:


a. Mbështetja për sinjalistikën turistike:

b. Mbështetja për promovimin turistik:

Përsa më sipër, nga auditimi rezultoi se, nga MTM nuk ka asnjë njësi koordinimi apo informacion për të sqaruar në lidhje me ecurinë apo realizimin e këtyre projekteve dhe si kanë ndikuar këto në lidhje me 100 fshatrat, përveç realizimit të sinjalistikës turistike dhe certifikimit të agrobizneseve.

Fakti i buxhetit: Nga auditimi mbi masat e mara për të siguruar mbështetje financiare për mbulimin me financim të ÷Programit 100 fshatrat, me qëllim arritjen e objektivave nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në këtë program rezultoi se MIE, MK dhe MBZHR, nuk kanë pasur fonde në dispozicion, por edhe në ato raste kur kanë pasur MTM, AZHBR, IKTK shpenzimet janë realizuar nëpërmjet programeve buxhetore të ndryshme nga ai i dedikuar për 100 fshatrat (përveç AKPT^{-së}):

Shpenzimet faktike të kryera sipas ministrive dhe agjencive në lekë, paraqiten sipas grafikut ÷Shpenzimet buxhetore për “Programin 100 fshatrat” për periudhën 01.01.2018 – 31.03.2022”, sa më poshtë vijon:




Burimi: MBZHR, MTM, MK, MIE
Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Gjendja e financimeve sipas institucioneve të audituara në funksion të programit të auditimit paraqitet:

MBZHR: me shkresën nr. 2901/1, datë 30.04.2018 drejtuar MFE, ÷Mbi projektbuxhetin afatmesëm 2019 -2021, të MBZHR, ka kërkuar shtesë 200 milion lekë në fonde për ÷Projektin për 100 fshatrat për investime (artikulli 231), me arsyetimin: *÷jo vetëm si politika të reja, por edhe si domosdoshmëri e shtesës së tavaneve*”. Argumentimi i kësaj kërkesë është ÷synimi i koordinimit në ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, si fokusim i qendëruar i investimeve publike, atyre të donatorëve dhe i investimeve private në hapësirën e 100 fshatrave”. Një arsye tjetër është edhe: ÷Në përmbushje të kërkesave dhe rekomandimeve të Progres Raportit të vitit 2017 nga Bashkimi Europian, si fonde shtesë për realizimin e produktit “Plotësimi nga ana e Shqipërisë e regjistrimit të fermës”. Me ligjin nr.99/2018, ÷Për buxhetin e vitit 2019 fonde prej 1,000,000 mijë lekë i është dhënë FSHZH, si Agjenci zbatuese. MBZHR^{-së} në lidhje me fondet e kërkuara **nuk** i është parashikuar në buxhet asnjë vlerë monetare.

FSHZH: Në MBZHR, si udhëheqëse e strategjisë, na u vu në dispozicion shkresa e cila është përgjigje bazuar në kërkesën për informacion të MBZHR me nr. prot., 1409, datë 02.03.2022, drejtuar FSHZH (e prot., me nr.683, datë prot., 03.03.2022, me kthim përgjigje nr.683/1, datë 11.03.2022), nga ku rezultoi se FSHZH, deri në mars 2022, ka ndërmarrë 88 projekte zhvillimore, të cilat *bien në territorin e 100 fshatrave* apo kanë impakt të drejtpërdrejtë në zonat e tyre me një vlerë totale investimi prej 32 miliard lekë, me përfitues direkt 76 fshatra dhe /ose zonat përreth tyre, nga të cilat grafikasht sa me poshtë:



Burimi i të dhënave shkresa e FSHZH drejtuar MBZHR me nr.683/1, datë 11.03.2022.

Sipas të dhënave të paraqitura, për titullin e programit ÷Programi i integruar në 100 fshatrat÷, gjendja paraqitet:

- Janë me status në proces prokurimi me financues GOA, 6 objekte të shtrirë nga ana gjeografike sipas tabelës sa më poshtë vijon në shumën 1,026,703,081 lekë;
- Janë në fazë të përgatitjes së termave të referencës (TOR) 3 objekte me financues GOA në shumën 400,000,000 lekë;
- Janë me status në proces zbatimi me financues GOA në shumën 434,654,408.40 lekë 2 objekte.

(Më hollësisht të dhënat janë në aneksin nr. B (projektet të cilat lidhen në emërtim me 100 fshatrat) dhe C (të dhëna në total të paraqitura me shkresën e FSHZH^{së}), bashkëlidhur).

Rezulton se për këtë program qeveritar në FSHZH, ende nuk ka rezultate konkrete, pasi punët civile e të tjera sikurse sipërcituar, janë në fillimet e punës. Puna e kryer e paraqitur me shkresën e FSHZH nr.683/1, datë 11.03.2022, ka ndikim indirekt, pasi janë punë civile të cilat edhe pse nuk kanë lidhje direkte me investimet për 100 fshatrat, ndërtimi i tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë për zhvillimin e zonës.

Nga auditimet e KLSH konstatohet se, ÷Programi 100 fshatrat÷ me kod 04230, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, në FSHZH nuk ka ecuri për sa kohë që fondet e akorduara për këtë program kanë kaluar në një program tjetër zhvillimi.

AZHBR: Kjo Agjenci funksionin si agjenci e pagesave, në kuptim të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.20.2007, ÷Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural÷, funksionon sipas VKM nr.719, datë 31.10.2014 të ndryshuar me VKM nr. 877, datë 14.12.2016 dhe me VKM nr. 322, datë 31.05.2018.

Nga auditimi rezultoi se nga 97 aplikime për agroturizëm e turizëm rural, të aplikuara në AZHBR, për vitet 2018 ó mars 2022, janë kontraktuar 27 subjekte, nga të cilat 17 janë të ÷Programit të 100 fshatrave÷. Financimi për 100 fshatrat është në vlerën 83,857,879 lekë, ose masën 59% të vlerës së grantit në total.

Vitet	Aplikime	Vlera e grantit	Vlera e grantit për 100 fshatrat
-------	----------	-----------------	----------------------------------

	Në total	kontraktuar	Sa në 100 fshatrat	Në total granti	Paguar	Në %	Granti për 100 fshatrat	Paguar për 100 fshatrat	në %
2018	32	17	12	104,883,672	94,930,622	90.5	68,789,404.00	68,789,404	100
2019	19	4	2	18,949,867	17,677,457	93.3	9,109,658.07	8,236,970	90.4
2020	4	2	1	7,289,039	7,289,039	100	2,353,750	2,353,750	100
2021	42	4	2	26,627,392	4,477,755	16.8	13,153,633	4,477,755	34
shuma	97	27	17	157,749,970	124,374,873	78.8	93,406,445.07	83,857,879	90

Burimi i të dhënave AZHBR.

E vetmja e veçantë për 100 fshatrat në këtë Agjenci, është prioriteti që kanë aplikuesit e 100 fshatrave duke u vlerësuar me 10 pikë plus në dallim nga aplikantët e territoreve të tjera. Gjithashtu ky është i vetmi kontribut i dhënë nga MBZHR-AZHBR, nëpërmjet udhëzimeve përkatëse të dala nga kjo ministri.

Nga auditimi i likuidimeve të granteve rezulton se shpenzimet për 100 fshatrat janë të kanalizuar në grupin 5, kapitulli 01, kod programi **04250** ÷Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë dhe agroindustrinë, në shumën 83,857,879 lekë. Pra, as në AZHBR, fondet për 100 fshatrat nuk janë të drejtuara nga programi i buxhetit me numër 04230 ÷100 fshatrat.

AKPT: Në lidhje me shpenzimet financiare, referuar pikave 7-11 të VKM nr. 492, datë 26.07.2018, ÷Për miratimin e mënyrës së rregullimit të aktiviteteve të nismës ÷Akademia 100+ Fshatrat, shpenzimet për aktivitetet e nismës mbulohen nga buxheti i miratuar për AKPT.¹¹

Për zbatimin e aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat", në mbështetje të ÷Programit 100 fshatra, MIE ka siguruar në PBA^{në} e vitit 2018 përmes projektit me Kod M064241 ÷Fondi i ngrirë ÷ Shërbim Konsulence (Programi i 100 Fshatrave), një vlerë prej 32,700,000 lekë (vlera të marra nga projekti "Për zhvillimin e zonës së liqenit të Pogradecit, Tushemisht – Drilon" dhe "Programi i 100 Fshatrave" AKPT), e cila do të kalohej AKPT, për vijimin e procesit sipas VKM nr. 492/2018, datë 26.07.2018, ÷Për miratimin e mënyrës së rregullimit të aktiviteteve të nismës ÷Akademia 100+ Fshatrat. Në zbatim të VKM nr. 492, datë 26.07.2018 ÷Për mënyrën e rregullimit të aktiviteteve të nismës ÷Akademia 100+fshatrat, në zbatim të programit kombëtar të zhvillimit rural me fokus 100+ fshatra, AKPT është angazhuar në realizimin e kësaj nisme me një seri aktiviteteve me objektiv: ÷Hartimin e modeleve të zhvillimit për secilin prej 100+ fshatrave. Ky projekt nuk ka qenë i parashikuar në PBA^{në} 2017-2020, pasi vendimi ka dalë më datë 26.07.2018. Më poshtë buxheti i miratuar për vitin 2018, referuar shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Viti 2018- buxheti					
		Fillestar	Shtim fonde	Shtim fonde	Pakësim fonde	Rishikimi	Realizimi
M064246	Planifikimi i modeleve të	0	12,000,000	20,700,000	6,500,000	26,200,000	24,412.000

¹¹ ÷Pika 8. Aktivitetet që përballohen nga buxheti i Agjencisë, janë:

- Aktivitetet e logjistikës;
- Dietat ditore për punën jashtë qendrës së banimit;
- Honorare për pozicionet e listuara në pikat 1, 2, 4 e 5, të këtij kreu.

Pika 9. Për zbatimin e aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat", Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit mundëson angazhimin e grupit të punës dhe të udhëheqësve rajonalë duke lidhur tipat e kontratave, si më poshtë:

- Kontratë bashkëpunimi për drejtuesin e grupit të punës;
- Kontratë bashkëpunimi për asistentin e grupit të punës;
- Kontratë bashkëpunimi për përpunuesin grafik;
- Kontratë bashkëpunimi për udhëheqësin rajonal.

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Viti 2018- buxheti					
		Fillestar	Shtim fonde	Shtim fonde	Pakësim fonde	Rishikimi	Realizimi
	zhvillimit për 100 fshatrat						

Burimi i të dhënave AKPT

Buxheti i miratuar për vitet 2018-2022 dhe fakti :

Viti	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti		Realizimi	Angazhimi
			Parashikuar në PBA	I rishikuar		
2018	M064246	Planifikimi i modeleve të zhvillimit për 100 fshatrat	-	26,200,000	24.412,000	
2019	M064246	Planifikimi i modeleve të zhvillimit për 100 fshatrat	34,380,000	-		
2020	M064246	Planifikimi i modeleve të zhvillimit për 100 fshatrat	15,000,000	5,000,000		
2021	M064246	Planifikimi i modeleve të zhvillimit 100 fshatrat itinerari gjurmë fishtiane	10,040,000	10,040,000	2,172,657	3,584,863
2022	M064246	Planifikimi i modeleve të zhvillimit 100 fshatrat itinerari gjurmë fishtiane	10,040,000	-		

Burimi i të dhënave AKPT

Gjatë vitit 2018, fondi i shpenzuar për këtë projekt ka arritur në vlerën 24,412,000 lekë ose në masën 93.18 %, të planit të miratuar, fond ky i shpenzuar për mbulimin e honorarëve të grupeve të punës dhe udhëheqësve rajonal, referuar Lidhjes nr.1, të VKM-së nr. 492, datë 26.07.2018, òMbi masat e pagesave si dhe kontratave të bashkëpunimitò.

Gjatë vitit 2020, fondi i miratuar për òPlanifikimi i modeleve të zhvillimit të 100 fshatraveò në vlerën 15,000,000 lekë nuk është shpenzuar si rezultat i situatës së vështirë të shkaktuar nga Pandemia Covid-19 si dhe referuar njoftimeve të APP-së nr. 2245 prot., datë 12.03.2020 dhe nr. 2339 prot., datë 27.03.2020, òPër pezullimin e shpalljes së procedurave të prokurimit, për objekte prokurimi të cilat nuk lidhen ngushtë me këtë situatë. Në zbatim të Aktit Normativ nr.28, datë 02.07.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, òPër buxhetin e vitit 2020ò, të ndryshuarò, ky fond është pakësuar dhe fondi i mbetur nuk mbulonte vlerën e parashikuar për realizimin e këtij investimi.

Në lidhje me òPlanifikimi i modeleve të zhvillimit 100 fshatrat itinerari gjurmë fishtianeò, gjatë vitit 2020 fondi i miratuar për të është në vlerën 15,000,000 lekë, të cilat nuk janë shpenzuar si rezultat i situatës së vështirë të shkaktuar nga Pandemia Covid-19 si dhe referuar njoftimeve të APP-së nr. 2245 prot., datë 12.03.2020 si dhe nr. 2339 prot. datë 27.03.2020, për pezullimin e shpalljes së procedurave të prokurimit, për objekte prokurimi, të cilat nuk lidhen ngushtësisht me këtë situatë. Në zbatim të Aktit Normativ nr.28, datë 02.07.2020, òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, òPër Buxhetin e vitit 2020ò, të ndryshuar, ky fond është pakësuar dhe fondi i mbetur nuk mbulonte vlerën e parashikuar për realizimin e këtij investimi. Gjatë vitit 2021 u realizua projekti òPlanifikimi 100 fshatrat- Itinerari Gjurmë Fishtianeò, projekt i nisur në vitin 2021 dhe që përfundon në vitin 2022. Vlera totale e projektit është 5,757,520 lekë me TVSH. Gjatë vitit 2021, është realizuar faza I dhe II e tij dhe fondi i shpenzuar është në vlerën 2,172,657 lekë. Faza III dhe IV e këtij projekti përfundon në vitin 2022, vlera e së cilës është 3,584,863 lekë.

Shpenzimet e kryera nga AKPT për këtë akademi janë kryer brenda programit të dedikuar 04230, me kod projekti M064246 òHartimi i modeleve të 100+ fshatratò dhe janë në shumën 26,584,657 lekë.

MIE: Kjo Ministri ka pjesëmarrjen e vet nëpërmjet AKPT dhe FSHZH. Me shkresën protokolluar me nr. 3196 prot., datë 18.03.2019 në MIE, nga FSHZH, me objekt òKërkesë për informacion mbi projektet në kuadër të òProgramit të 100 Fshatratò, në të cilën i kërkon:

- Projektet që MIE ka në zbatim në lidhje me sektorët përgjegjës mbi infrastrukturën, lidhur me 100 Fshatrat dhe projekte të gatshme për zbatim që lidhen me ÷Programin e 100 fshatrave dhe që nuk janë të mbuluar me financim.

Kësaj kërkesë MIE, i është përgjigjur me shkresën nr. 3196/1, datë 05.04.2019, ku ndër të tjera citohen fshatrat Tushemisht ó Projekt për zonën e liqenit të Pogradeci (Tushemisht-Drilon). Në këtë projekt MIE do të ishte partner në investim përmes marrëveshjes me AADF, të cilat ishin të parashikuara të mbështeteshin financiarisht nga MIE.

Si mundësi për financim të mëtejshëm për ÷Programin 100 fshatrat, MIE ka të parashikuar në PBA e vitit 2022-2024 projektin ÷Për zhvillimin e zonës së liqenit të Pogradecit, Tushemisht ó Drilon, me një vlerë prej 20 milion lekë, për vitin 2023. Ndërkohë, nga MFE është duke u ndjekur procedura e miratimit të projektvendimit ÷Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) për projektin për zhvillimin e eko-turizmit në zonën Drilon-Tushemisht që lidhet me këtë projekt, për të cilin MIE shprehet se i nevojitet një informacion i detajuar, me specifikimet përkatëse, për aktivitetet që duhet të përfshihen në buxhetin e saj për realizimin e këtij projekti.

Këto parashikime rezultojnë të jenë jashtë afateve të VKM nr. 21, datë 12.1.2018¹².

Si konkluzion, nga ana e MIE nuk është bërë buxhetim për programin qeveritar 100 fshatrat.

MTM: Në përmbushje të funksionit dhe kontributit të MTM për ÷Programin 100 fshatrat, është realizuar Projekti: "Vendosja e sinjalistikës 100 fshatrat dhe plazhet", konkretisht MTM në lidhje me ÷Programin e 100 fshatrave, ka planifikuar në buxhet dhe ka realizuar 2 procedura prokurimi në vitin 2018, sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Objekti i prokurimit:	Viti 2018		
	Plani përfundimtar	Fakti	Në %
Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve pritëse, vendosja e sinjalistikës turistike në destinacionet e agroturizmit përfshirë në projektin 100 fshatrat.	67,665,348	67,596,232	99.9%
Studim dhe Projektim në lidhje me sinjalistikën turistike në destinacionet e agroturizmit përfshirë në projektin 100 fshatrat si dhe vendosja e sinjalistikës informuese në plazhet që paraqesin rrezikshmëri të lartë për shëndetin dhe sigurinë fizike si dhe tabela me rregullat e arta.	4,798,800	4,798,800	100%

Burimi i të dhënave MTM

Kjo Ministri është përfshirë në ÷Programin e 100 fshatrave, nëpërmjet dy procedurave të prokurimit:

- Kontrata nr. 7697/12, datë 27.11.2018, me objekt: ÷Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve pritëse, vendosja e sinjalistikës turistike në destinacionet e agroturizmit përfshirë në projektin 100 fshatrat, me vlerë kontrate 67,596,232 lekë.

- Kontrata nr. 5070, datë 28.08.2018, me objekt: ÷Studim dhe Projektim në lidhje me sinjalistikën turistike në destinacionet e agroturizmit përfshirë në projektin 100 fshatrat si dhe vendosja e sinjalistikës informuese në plazhet që paraqesin rrezikshmëri të lartë për shëndetin dhe sigurinë fizike si dhe tabela me rregullat e arta, me vlerë kontrate 4,798,800 lekë. Vlera totale e likuiduar për këto dy projekte, është në shumën 72,395,032 lekë.

Të gjitha likuidimet kanë kaluar me kod programi 04760 ÷Zhvillimi i Turizmit dhe jo me kodin e programit 04230 ÷Programi 100 fshatrat.

Kësaj Ministrie me kërkesë të vetë, i janë hequr fondet sa më poshtë vijon: Me shkresën nr.5131 datë 29.05.2019, MTM, i ka kërkuar MFE kërkesë për rishpërndarjen e shpenzimeve

¹² Për disa shtesa në Vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, ÷Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020

kapitale me arsyetimin se: ÷Projekti ÷Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve pritëse, vendosja e sinjalistikës turistike në destinacionet e agroturizmit përfshirë në projektin 100 fshatrat, me kod projekti M260403 të mos realizohet për vitin 2019 mbasi FSHZH është struktura përkatëse që merret me zhvillimin e infrastrukturës në këtë projekt të madh dhe mbulon të gjitha kërkesat për fonde financiare për nevojat që ka ky projekt. Duke parë nevojën për përmirësimin e infrastrukturës në zonën e Kune ó Vainit, kërkojmë që fondi i dedikuar për 100 fshatrat të kalojë në projektin e ri ÷Përmirësim infrastrukturë në zonën e mbrojtur Kune ó Vain, Lezhë, mbështetur në përmirësimin e situatës mjedisore në zonën e Vainit. MFE me shkresën nr. 103291/1, datë 11.06.2019, ka hequr shumën prej 100 milion lekë nga projekti me kod projekti M 260403.

MK: Nëpërmjet IKTK, në zbatim të Aktit Normativ nr.28, datë 02.07.2020 rezultoi se ka kryer tre restaurime sa vijon:

- Restaurimi i kishës së Shën e Premtes, Lukovë, në shumën 3,606,109.76 lekë, likuiduar me kod programi 08220.
- Restaurimi i kishës së Profet Ilisë, Stegopull, Gjirokastrë, në shumën 7,759,131 lekë, me kod programi 08220.
- Restaurimi i çatisë në kishën e Shën Thanasit, Voskopojë, Korçë, me kontratë sponsorizimi nga Banka Amerikane e Investimeve sha, vlera 50,000 euro me tvsh, miratuar me Vendimin nr.433, datë 21.07.2021 (nr. prot 1108, datë 21.07.2021 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore materiale.

MK nuk i ka kaluar shpenzimet ne programin e caktuar 04230.

Gjetje nga auditimi:

10. Për këtë program qeveritar, ka pasur një program të dedikuar buxhetor, konkretisht ÷Programi 100 fshatrat me kod 04230, ku presupozohet se të gjitha fondet, në lidhje me këtë projekt, pavarësisht njësisë shpenzuese, duhet të kalojnë nëpërmjet këtij programi, në mënyrë që të gjurmohen edhe shpenzimet kundrejt objektivave të parashikuara. Konkretisht:

AZHBR - Nga auditimi i likuidimeve të granteve rezulton se shpenzimet për 100 fshatrat janë të kanalizuar në grupin 5, kapitulli 01, kod programi 04250 ÷Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë dhe agroindustrinë, në shumën 83,857,879 lekë. Në AZHBR, fondet për ÷100 fshatrat nuk janë të drejtuara nga programi i buxhetit me numër 04230 ÷100 fshatrat;

AKPT: Shpenzimet e kryera nga AKPT për këtë akademi janë kryer brenda programit të dedikuar 04230, me kod projekti M064246 ÷Hartimi i modeleve të 100+ fshatrat dhe janë në shumën 26,584,657 lekë;

MTM: Të gjitha likuidimet kanë kaluar me kod programi 04760 ÷Zhvillimi i Turizmit dhe jo me kodin e programit 04230 ÷Programi 100 fshatrat. Vlera totale e likuiduar për këto dy projekte, është në shumën 72,395,032 lekë.

MK: nuk i ka kaluar shpenzimet në programin e caktuar 04230, shpenzimet janë kryer nga IKTK në shumën 11,365,241 lekë.

Konkluzione:

6. Nuk është zbatuar në të gjitha rastet kodi i programit 04230, por këto shpenzime kanë kaluar në programe me kode të tjera. Në këtë mënyrë, fondet e ÷Programit të 100 fshatrave, nuk bëhen të monitorueshëm në nivel strategjik.

Rekomandime:

10. MBZHR, MTM, MIE dhe MK, si dhe institucionet e tyre të varësisë që menaxhojnë fonde nga ÷Programi i 100 fshatrave, të marrin masa që përgjatë planifikimit e deri në ekzekutimin e shpenzimeve, fondet të kalojnë në programin për 100 fshatrat, me kod 04230,

me qëllim që fondet e dedikuara për këtë program të administrohen me efektivitet dhe të kontribuojnë së bashku në prodhimin e produkteve të identifikueshme dhe të matshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar AZHBR, është paraqitur komenti me nr. 2276/1/03 prot., datë 12.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/13, datë 12.07.2022, e firmosur nga znj. E. S., me detyrë Drejtore e Përgjithshme e AZHBR, ku janë shprehur komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Referuar kësaj gjetje sqarojmë se AZHBR është institucion varësie i MBZHR dhe si i tillë është institucion zbatues. Buxheti dhe programet buxhetore nën të cilat operon AZHBR janë të përcaktuara nga MBZHR, çdo fillim viti buxhetor.

AZHBR menaxhon fonde nën programin buxhetor 04250, “Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë dhe agroindustrinë”, program ky i përcaktuar nga MBZHR si institucioni kryesor dhe politikë bërës nga i cili varet AZHBR.”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar nga ana e juaj ju bëjmë më dije se grupi i auditimit ka nxjerrë në pah faktin se ky program nuk ka kaluar në një program buxhetor.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar MBZHR, është paraqitur komenti me nr. 2079/05 prot., datë 27.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/15, datë 28.07.2022, ku janë shprehur komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për gjetjen nr.10, ku komentohet se: MBZHR nuk ka pasur fond të dedikuar për këtë program, pavarësisht kërkesave të bëra për këtë qëllim. Skemat e mbështetjes përmes financimit nga buxheti celen në llogarinë 606, ÷Transferita në buxhetet familjareö dhe si të tilla brenda programit të MBZHR-së, 04250, transferohet një fond i destinuar për një qëllim të caktuar në një zë tjetër të një institucioni tjetër, kur nuk ka pasur një çelje të tillë me ligj.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar nga ana e juaj ju bëjmë më dije se grupi i auditimit ka nxjerrë në pah faktin se ky program nuk ka kaluar në një program buxhetor.

IV.2.2 A i ka shërbyer mbështetja financiare realizimit të objektivave të “Programit të 100 fshatrave”?


Në funksion të programit me fokus krijimin e 100 zonave të zhvillimit ekonomik rural, të bazuara tek investimet në agroturizëm dhe ekoturizëm, duke shfrytëzuar trashëgiminë kulturore, mrekullitë natyrore, traditën në tërësi, kapacitetet lokale, por edhe investimet e sipërmarrjes, sipas institucioneve veprimtaria për këtë program paraqitet:

AKPT: në lidhje me ÷Programin e 100 fshatraveö ka funksionuar bazuar në VKM nr. 492, datë 26.7.2018, ÷Për miratimin e mënyrës së rregullimit të aktiviteteve të nismës ÷Akademia 100 + fshatratö, në zbatim të Programit Kombëtar të Zhvillimit Rural me fokus 100 + fshatraö.

÷Akademia e 100 fshatrave +ö, është një nismë me një seri aktiviteteve që kanë si **objektiv kryesor hartimin e planeve të zhvillimit territorial dhe modeleve të zhvillimit ekonomik për secilin prej fshatrave**, nga ku ka rezultuar se:




Janë identifikuar potenciali dhe kapacitetet njerëzore të fshatrave, elementët fizikë të traditës, trashëgimisë, natyrës e pejsazhit të këtyre komuniteteve, të cilat janë rivlerësuar gjatë punës për hartimin e modeleve të zhvillimit, brenda kornizës së zhvillimit të turizmit rural me fokus agroturizmin, ekoturizmin dhe turizmin e natyrës.



Ka identifikuar banesat me vlera arkitektonike, banesat e braktisura me potencial për t'u transformuar, elementët e hapësirave të përbashkëta që mund të kthehen në hapësira të komunitetit, ngrehinat e braktisura me potencial për t'u shndërruar në nyje zhvillimi, shtigjet historike në natyrë që lidhin pika tërheqëse për vizitorët, itinerare të mundshme turistike dhe të tjera aspekte me vlerë për t'u zhvilluar në kuadër të turizmit rural.

Për organizimin e serisë së aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat" duhet të ofronin mbështetje institucionet qendrore e vendore, si më poshtë:



Nëpërmjet aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat" janë **përftuar**:

- Planet e zhvillimit territorial dhe modelet e zhvillimit ekonomik për 100 + fshatrat, pjesë e Programit Kombëtar të Zhvillimit Rural;
- Ide, plane biznesi dhe projekte për nxitjen e zhvillimit të 100 + fshatrave, të cilat mund të kthehen në projekte zbatimi për t'u investuar nga
 - Burime të ndryshme si publike, private, të donatorëve apo kombinimi i tyre;
 - Dije të shtuara për 100 + fshatrat, të cilat do t'u përcillen institucioneve vendore e qendrore për t'u përdorur më tej në aktivitetin e tyre.

Sipas përcaktimeve të VKM-së ministritë, nëpërmjet pikave të kontaktit, 61 bashkitë nëpërmjet drejtorive të planifikimit, turizmit, zhvillimit rural (bujqësisë), administratorëve dhe kryepleqve, agjencitë kombëtare si AKZM, IKTK, AZHBR, 4 AZHR-të, FSHZH, INSTAT, etj, kanë ofruar mbështetje sipas fushës së përgjegjësisë, të cilat konsistojnë në:

- ❖ Të dhëna (informacione), për fusha të ndryshme, që prekin 100+ fshatrat (ministritë, agjencitë, bashkitë, FSHZH, INSTAT);
- ❖ Shoqërim dhe informim në terren (drejtoritë e bashkisë, administratorët dhe kryepleqtë, INSTAT);
- ❖ Mbështetje logjistike në terren (bashkia);
- ❖ Këshillim dhe udhëheqje gjatë takimeve prezantuese dhe konsultative/ orkshops (ministritë, agjencitë, bashkitë, FSHZH).

Në bashkëpunim me INSTAT, AKPT ka hartuar 5 pyetësorë, të cilët janë plotësuar gjatë në ekpedita në fshatra, me ndihmën e grupeve të punës. Janë hartuar dhe plotësuar pyetësorë për familjet, për bizneset, për turistët vendas dhe të huaj, si edhe për kryepleqtë. Pyetësorët kanë shërbyer për të njohur komunitetet banuese dhe vizitorët e këtyre fshatrave, për të kuptuar

potencialet, sfidat dhe çështjet më të cilat ato përballen. Mbi bazën e këtyre njohurive, grupet e punës kanë ndërtuar propozimet e tyre për modelet e zhvillimit në fshatra. Ndërveprimi me komunitetin e përhershëm (banor, biznes) dhe atë të përkohshëm (turist), ka qenë nëpërmjet takimeve individuale, bashkëbisedimit dhe plotësimit të pyetësorit me shumë pyetje. Janë plotësuar rreth 1203 pyetësorë në 98 fshatra.

Sipas përcaktimeve të Termave të Referencës janë hartuar $98+21=119$ plane zhvillimi territorial, për 98 fshatra dhe 21 rajone/loje.

Përveçorkshop^{eve} dhe leksioneve që janë organizime të mëdha, në zyrat e AKPT^{së}, gjatë ekspeditave në terren dhe në studiot e punës së grupeve të punës janë zhvilluar në vazhdimësi mbledhje pune me pjesëmarrjen e më shumë aktorëve sesa vetë grupi i punës, për të konsultuar tematika të ndryshme, sipas nevojës.

Aktorët pjesëmarrës në takimet me pjesëmarrje të gjerë kanë qenë:

Anëtarët e grupeve të punës;
Udhëheqësit rajonalë nga UBT dhe FE/UT;
Përfaqësues të institucioneve qendrore (ministri, agjenci, FSHZH, INSTAT);
Përfaqësues të bashkive, sipas kërkesës;
Njerëz të sukseshëm në fushën e zhvillimit rural dhe agroturizmit;
Profesorë të spikatur nga 6 universitetet.

Pas përfundimit të Akademisë 100+ Fshatrat, është punuar nga AKPT dhe Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) në Kryeministri, nën drejtimin e Koordinatorës Kombëtare për "Programin e 100 fshatrave", për grupimin e fshatrave në nëngrupe. Është përgatitur një metodologji mbi bazën e diskutimeve në workshop^{et} e organizuara midis AKPT dhe EMP, me qëllim identifikimin e grupimit të fshatrave, në mënyrë që të ndërtoheshin në vijim dhe profilet e modeleve të zhvillimit në këtë nivel. Identifikimi dhe përzgjedhja e fshatrave të cilët mund të jenë pjesë e një grupimi ka ardhur si rrjedhojë e leximit të elementëve territorialë që lehtësojnë lidhjen e fshatrave mes tyre. (sa më sipër këto të dhëna u morën nga AKPT).

Duke marrë në konsideratë nevojat dhe projektet e identifikuar nga Akademia, apo dhe aktorët rajonal/lokal (ish AZHR^{te} dhe bashkitë), synimi kryesor ka qenë që investimet publike të jenë me impakt më të gjerë sesa vetëm fshatin, pra ndikimi të jetë në grup-fshatrash, dhe të ketë një shpërndarje të projekteve të financuara në gjithë territorin e vendit. Për këtë arsye janë analizuar disa skenarë për kanalizimin e financimeve".

Informimi i publikut për produktin e prodhuar.

• Akademia 100+Fshatrat, është njoftuar publikisht nga Kryeministri dhe Ministrat, pjesë e Programit të 100 fshatrave, në media dhe rrjetet sociale FB dhe IG, në faqet e b të Këshillit të Ministrave dhe AKPT^{së}, nga zyra e shtypit të Kryeministrit dhe nga stafi i AKPT^{së}.

- ❖ Nënshkrimi i marrëveshjeve me 6 universitetet është bërë publik live nga Kryeministri;
- ❖ Nisja e Akademisë në terren është bërë publike live nga Kryeministri;
- ❖ Çdoorkshop është bërë publik live nga AKPT, në FB dhe IG;
- ❖ Çdo vizitë në terren është bërë publike nga secili grup, në IG;

- ❖ Në web AKPT, janë publikuar të reja rreth Akademisë;
- ❖ Të interesuarit, nëse kanë dërguar pyetje drejt AKPT-së, kanë marrë përgjigje me shkresë apo me e-mail;
- ❖ Takimi prezantues përmbyllës dhe ekspozita e produkteve të Akademisë 100+ Fshatrat është bërë publik -live nga Kryeministri. Prezantimi dhe ekspozita u zhvilluan në Sheshin Skënderbej, në mjedis të hapur, të aksesueshem nga gjithkush.

Përdorimi nga institucionet vendore e qendrore i planeve të hartuara nga AKPT, për t'u përdorur më tej në aktivitetin e tyre.

Nga ana e AKPT^{së}, sipas plotësimit të pyetësorit të paraqitur nga grupi i auditimit të KLSH^{së}, rezulton se: *institucionet vendore e qendrore të kenë marrë informacionin e prodhuar nga "Akademia 100+ Fshatrat", në disa mënyra:*

- *Dorëzim i paketës përmbledhëse në takimin përfundimtar prezantues, në fund të muajit dhjetor;*
 - *Informim për publikimin e dokumenteve të Akademia 100+ fshatrat në web AKPT për shkarkim;*
 - *Dërgesë me shkresë përcjellëse nga AKPT;*
 - *Ndarje e informacionit me grupet e punës që hartojnë planet e përgjithshme vendore (PPV), për përfshirjen e planeve të zhvillimit territorial dhe modeleve të zhvillimit në PPV dhe si rrjedhojë konsiderimin e tyre në hartimin e PBA-ve në vitet në vijim;*
 - *Takime me përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore për t'u prezantuar planet dhe modelet dhe për të diskutuar mbi prioritizimin e propozimeve të Akademia 100+ fshatrat.*
- Po sipas AKPT^{së}, "6-mujori i parë i vitit 2019, për AKPT-në ka qenë një proces pune intensive për të ndërtuar, në bashkëpunim me ministrinë dhe FSHZH, një bazë informacioni të detajuar që do t'i shërbente krijimit të Programit të Investimeve në kuadër "Programit të 100 fshatrave". Gjatë këtij procesi, kemi ndarë e shpërndarë njohuritë e përfuara nga Akademia, si edhe idetë për zhvillimin e 100+ fshatrave me shumë aktorë të përfshirë, ku pjesë ishin edhe organizata të ndihmës së huaj, të cilat iu bashkuan Programit të 100 fshatrave" duke vijuar me iniciativa mbështetëse".*

Gjetje nga auditimi:

11. Në AKPT, produkti i realizuar në finalizim e nismës së Akademia 100 + fshatrat, janë fletëpalosje dhe botime informuese për secilin prej fshatrave, ku evidentohen atraksionet turistike, kulinare, apo edhe potencialet për zhvillim, të cilat janë publikuar edhe në faqen e saj të web-it. Edhe pse Akademia 100 + fshatrat, ka përgatitur hartimin e modeleve të zhvillimit për secilin prej fshatrave, bazuar tek potenciali i tyre turistik, në përfundim vëmë re se nuk ka plane biznesi dhe projekte; nuk është bërë preventiv apo kostim i këtij projekti, mbi të cilin të mbështeten më tej buxhetet individuale, për të gjitha njësitë e përfshira për nxitjen e zhvillimit të 100 + fshatrave, të cilat mund të kthehen në projekte zbatimi për t'u investuar nga burime të ndryshme si publike, private, të donatorëve apo kombinimi i tyre.

Konkluzioni:

7. Nga ana e AKPT mungojnë plane biznesi dhe projekte, preventiva apo kostime të këtyre projekteve, mbi të cilin të mbështeten më tej buxhetet individuale, për të gjitha njësitë e përfshira për nxitjen e zhvillimit të 100 + fshatrave, të cilat mund të kthehen në projekte zbatimi për t'u investuar nga burime të ndryshme si publike, private, të donatorëve apo kombinimi i tyre.

Rekomandime:

11. Nga AKPT të shikohet mundësia për hartimin e plan-bizneseve dhe preventivave apo kostimeve të këtyre projekteve, mbi të cilin të mbështeten më tej buxhetet individuale për njësitë shpenzuese të përfshira, të cilat mund të kthehen në projekte zbatimi për t'u investuar nga burime të ndryshme si publike, private, donatorë apo kombinimi i tyre.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar AKPT, është paraqitur komenti me nr. 512/03 prot., datë 22.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/14, datë 22.07.2022, nga AKPT, Drejtoria Juridike, Burimeve njerëzore dhe informimit, e firmosur nga znj. A. G., me detyrë Drejtore e Përgjithshme e AKPT, ku janë shprehur prapësimet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

“Nga teksti i raportit kuptojmë se grupi i auditimit:

- *Nuk është njohur me detyrat e caktuara për AKPT- në në këtë proces;*
- *Nuk ka kuptuar rolin e AKPT-së në kuadër të programit të 100 fshatrat;*
- *Nuk është njohur thellësisht me produktet e punës ku ka kontribuar AKPT në këtë proces.*

Si rrjedhojë gjetjen, konkluzionin dhe rekomandimin e vlerësojmë të gabuar dhe të pabazuar. Theksojmë se, brenda kuadrit të “Programit 100 fshatrat”, AKPT është agjenci zbatuese vetëm për komponentin e “Akademisë 100+ fshatrat”.

Ndaj në përfundim i sugjerojmë grupit të auditimit që të auditojnë performancën e punës së AKPT-së vetëm brenda kuadrit të VKM 492/2018 dhe jo sipas botëkuptimit të tyre të gjera se si mund të ishte organizuar Programi 100 fshatrat në përgjithësi, nëse ata do të ishin politikë bërësit e Programit”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar nga ana e juaj ju bëjmë më dije se auditimi është mbështetur në VKM nr. 492, datë 26.7.2018, për miratimin e mënyrës së rregullimit të aktiviteteve të nismës òAkademia 100 + fshatratò. Bazuar në këtë VKM në përfundim vëmë re se nuk ka plane biznesi dhe projekte; nuk është bërë asnjë preventiv apo kostim i këtij projekti, mbi të cilin të mbështeten më tej buxhetet individuale, për të gjitha njësitë e përfshira për nxitjen e zhvillimit të 100 + fshatrave, të cilat mund të kthehen në projekte zbatimi për t’u investuar nga burime të ndryshme si publike, private, të donatorëve apo kombinimi i tyre, e përcaktuar në VKM nr. 492, datë 26.7.2018, për miratimin e mënyrës së rregullimit të aktiviteteve të nismës òAkademia 100 + fshatratò, pjesa II, òInstitucionet e përfshira dhe aktivitetet e nismës òAkademia 100 + fshatratò, pika 5/b, ku është përcaktuar se:

ò5. Nëpërmjet aktiviteteve të nismës “Akademia 100 + fshatrat” përftohen:

b) Ide, plane biznesi dhe projekte për nxitjen e zhvillimit të 100 + fshatrave, të cilat mund të kthehen në projekte zbatimi për t’u investuar nga burime të ndryshme si publike, private, të donatorëve apo kombinimi i tyre;.”.

Sa trajtuar më sipër komenti juaj nuk ka mbështetje ligjore e nuk merret në konsideratë.

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

MTM, ka qenë kontribuese në realizimin e òProgramit të 100 fshatraveò, me inpute për të dhëna nga bashkitë për plotësimin e skedave për potencialin turistik të tyre.

- Nga ana e saj, kjo Ministri, ka hartuar matricën në Excel mbi gjendjen në turizëm dhe mjedis në 100 fshatra (burime, shtigje, zona të mbrojtura, subjekte, promovim, menaxhim i mbetjeve dhe propozime konkrete për ndërhyrje), një skicë fillestare e një numri instrumentesh (për turizëm dhe mjedis), të cilat janë programe të aplikueshme për të gjithë fshatrat, si dhe një formular për të siguruar informacione të detajuara në çdo destinacion nga grupet e òAkademisë 100 fshatratò dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore.

- Gjithashtu, referuar procesit të certifikimit për subjektet që pajisen me certifikatë paraprake dhe certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit, deri mars 2022 janë certifikuar: 8 nga 21 subjektet e pajisur me certifikatën e agroturizmit të cilat janë pjesë e

listës së ÷Programit të 100 fshatrave, konkretisht në Shëngjergj, Radë, Gjepalaj, Rroshnik, Fishtë, Katund i Vjetër, Boboshticë, Nivicë, si dhe 2 nga 13 subjektet e pajisur me certifikatën paraprake të agroturizmit janë pjesë e listës së ÷Programit të 100 fshatrave, konkretisht në Borovë dhe Kaninë.

- Me shkresën nr. 6171, datë 18.07.2018, me lëndë ÷Mbi programin e zhvillimit 100 fshatrat, të MTM, i është drejtuar 61 bashkive të vendit, duke kërkuar bashkëpunim për sigurimin e të dhënave dhe një informacioni paraprak për ato fshatra sipas listës, bazuar në formularin bashkëlidhur, në të cilin janë përcaktuar plotësimi i burimeve natyrore, kulturore, sociale dhe ekonomike, akti

- Vitet që zhvillohen dhe që kanë potencial, prodhimet lokale, infrastruktura turistike në dispozicion, ofertuesit e akomodimit, ushqimit dhe pijeve, operatorët e turizmit dhe ofruesit e shërbimeve, pikat e informacionit për turistin dhe lehtësi të tjera, kanalet e promovimit, vlerësimi i kërkesës turistike si dhe propozime dhe projekte nëse ka. Ky informacion kërkohet të paraqitet brenda datës 03.08.2018. Kjo shkresë është firmosur nga H.Ç., me detyrë ish Zv/Ministër. Personi i kontaktit në këtë Ministri është caktuar B. Rr. (aktualisht të dy nuk janë më në këtë punë dhe nuk ka punonjës të tjerë që t'i jetë përcjellë puna).

- Është hartuar/krijuar një bazë të dhënash, me informacionin e marrë nga bashkitë dhe burime të tjera, mbi ÷Programin e 100 fshatrave, si; burimet turistike, zonat e mbrojtura, shtigjet dhe itineraret e udhëtimit, monumente historike dhe kulturore, natyrore, aktivitete turistike, infrastrukturën turistike, subjekte që ushtrojnë veprimtari turistike, etj. Gjithashtu specialistet e MTM që kanë qenë pjesë e plotësimit të të dhënave për skedat e 100 fshatrave, kanë marrë pjesë në orkshop-et e zhvilluara nga AKPT^{ja}, në kuadër të "Akademisë 100 fshatrat", ku grupe studentësh dhe ekspertësh në terren, kanë ndërtuar plan projektet për të gjitha fshatrat.

Ky dokumentacion nga grupi i auditimit të KLSH u morr nga arkiva e MTM. (Konkretisht na u vunë të dhëna sipas aneksit D, bashkëlidhur).

Kjo Ministri është përfshirë në ÷Programin 100 fshatrave, nëpërmjet dy procedurave të prokurimit:

Kontrata nr. 7697/12, datë 27.11.2018, me objekt ÷Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve pritëse, vendosja e sinjalistikës turistike në destinacionet e agroturizmit përfshirë në projektin 100 fshatrat, me vlerë kontrate 67,596,232 lekë. Data e fillimit të punimeve është 12.12.2018 dhe data e përfundimit 24.12.2018.

Kontrata nr. 5070, datë 28.08.2018 ÷Studim dhe projektim në lidhje me sinjalistikën turistike në destinacionet e agroturizmit përfshirë në projektin 100 fshatrat si dhe vendosja e sinjalistikës informuese në plazhet që paraqesin rrezikshmëri të lartë për shëndetin dhe sigurinë fizike si dhe tabela me rregullat e arta, me vlere kontrate 4,798,800 lekë.

Sipas kontratës nr.7697/12, datë 27.11.2018, ÷Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve pritëse, vendosja e sinjalistikës turistike në destinacionet e agroturizmit, përfshirë 100 fshatrat, rezulton se në dosjen e zbatimit janë fotot e 100 tabelave. Për ilustrim foto për tabelën tip sa vijon:



Foto nga grupi i auditimit

Rezulton se kolaudimi është kryer në të njëjtën ditë që kanë përfunduar punimet, (në një kohë që objekti është shumë i përhapur) edhe pse, në pikën 10 thuhet se: òKoha e zgjatjes së procesit të kolaudimit është dhjetë ditë nga data e dorëzimit të dosjes së objektit nga ana e mbikëqyrësit pranë AK. Ndërkohë data e fillimit të punimeve është 12.12.2018 ndërsa data e përfundimit dhe e kolaudimit është e njëjtë 24.12.2018 e cila është e pamundur nisur nga fakti që janë 100 tabela të shpërndara në të gjithë Shqipërinë për zonat sipas tabelave në anekset bashkëlidhur.

Gjetje nga auditimi:

12. MTM për shpenzimet e kryera për vendosjen e sinjalistikës informuese për programin e 100 fshatrave, ka bërë vetëm transferim fizik të tabelave por jo kalim kapital të tyre nëpër bashkitë përkatëse, duke mos i mbajtur në aktivet afat gjata të pasqyrave financiare të vetat për rrjedhojë duke i lënë pa mbikëqyrje, fakt ky i konstatuar edhe në verifikimin në terren ku rezultuan me mungesë sinjalistika në: Kosinë, Lukovë, Drisht, Mjedë, Zogaj, Fishtë, Roshnik, Kapinovë, Kozarë, Leusë, Gjepal, etj., (sipas aneksit të fotove bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Konstatuam se marrja në dorëzim e këtyre objekteve (referuar Akt-Kolaudimit), është kryer në të njëjtën datë me deklarimin e përfundimit të punimeve dhe me kohëzgjatje një ditë, në një kohë që objektet e marra në dorëzim, shtrihen në 100 vende, dhe fizikisht është e pamundur marrja në dorëzim brenda ditës.

Konkluzione:

8. Kolaudimi i objektit është bërë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të fushës së ndërtimit, duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi procesin.

9. Nuk ka asnjë të dhënë në MTM mbi gjendjen aktuale të tabelave dhe përgjegjësinë për humbjen e tyre.

Rekomandime:

12. MTM, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune nëpërmjet të cilit të analizojë gjendjen aktuale të tabelave të sinjalistikës informuese, të identifikojë përgjegjësitë për rastet e mos menaxhimit të tyre, si dhe për kolaudimin e tyre në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të ndërtimit, dhe të marrë masa sipas shkeljeve të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

AGJENCIA E ZHVILLIMIT BUJQËSOR DHE RURAL:

AZHBR, si agjenci e pagesave, në kuptim të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.20.2007, òPër Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, funksionon sipas VKM nr.719, datë 31.10.2014 të ndryshuar me VKM nr. 877, datë 14.12.2016 dhe me VKM nr. 322, datë 31.05.2018.

Objektivat e drejtpërdrejta të legjislacionit të ri shqiptar për agroturizëm janë: Krijimi i një agroturizmi të qëndrueshëm dhe miqësorë për mjedisin dhe një atraksion gjithë vjetor; përgatitja e një plani sektorial të agroturizmit; Planifikim i zhvillimit të agroturizmit nëpërmjet përcaktimit të zonave që do të kenë turizëm dhe agroturizëm (*Programi 10 fshatrat, Programi për turizmin rural, Programi festat lokale. Marka, Logo, Made In Albania*); Rritja e numrit të turistëve , natë ó qëndrimeve dhe të ardhurave prej tyre; Rritja e cilësisë së shërbimeve; Reduktimi i informalitetit; Nxjtja e investimeve strategjike në turizëm dhe veçanërisht në agroturizëm; Rritja e cilësisë së jetës së komunitetit që preket nga sektori i agroturizmit; Krijimi i bazës së të dhënave për sektorin e agroturizmit

Nga auditimi rezultoi se nga 97 aplikime për agroturizëm e turizëm rural, të aplikuara në AZHBR, për vitet 2018 ómars 2022, janë kontraktuar 27 subjekte, nga të cilat 17 janë të òProgramit të 100 fshatrave, kryesisht janë investime:

- Në agroturizëm: që kanë të bëjnë me ndërtime, rikonstruksion, mobilim, makineri dhe pajisje për agroturizmin (ndërtesa të vjetra, kampingje, objekte rekreative, pajisje sportive, makineri përpunuese në fermë, etj.).


- Në turizëm rural: që ka të bëjë me investime për ndërtim, rikonstruksion dhe mobilim për bujtina 6-10 dhoma.

Tabela: Investimet e kryera në AZHBR sipas viteve për agroturizëm e turizëm rural në total dhe 100 fshatrat.

Vitet	Në total	Agroturizëm		Turizëm rural	
		Total	100 fshatrat	total	100 fshatrat
2018	17	13	8	4	4
2019	4			4	2
2020	2			2	1
2021	4	2	1	2	1
Total	27	15	9	12	8

Burimi i të dhënave AZHBR

Investimet (AZHBR)



Burimi i të dhënave AZHBR

Financimi për 100 fshatrat është në masën 59% të vlerës së grantit në total.


Konkretisht aplikimet dhe investimet në total dhe për 100 fshatrat në veçanti janë sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Tabela "Mbi aplikimet dhe investimet në total dhe për 100 fshatrat në veçanti" -Në lekë


Vitet	Aplikime			Vlera e grantit			Vlera e grantit për 100 fshatrat		
	Në total	kontraktuar	Sa në 100 fshatrat	Në total grantit	Paguar	Në %	Granti për 100 fshatrat	Paguar për 100 fshatrat	në %
2018	32	17	12	104,883,672	94,930,622	90.5	68,789,404.00	68,789,404	100
2019	19	4	2	18,949,867	17,677,457	93.3	9,109,658.07	8,236,970	90.4
2020	4	2	1	7,289,039	7,289,039	100	2,353,750	2,353,750	100
2021	42	4	2	26,627,392	4,477,755	16.8	13,153,633	4,477,755	34
shuma	97	27	17	157,749,970	124,374,873	78.8	93,406,445.07	83,857,879	90

Burimi i të dhënave AZHBR

Nisur nga sa trajtuam, rezulton se numri i aplikimeve ka rënë ndjeshëm në vitin 2020 (ku një faktor që ka ndikuar është edhe pandemia Covid 19), dhe është rritur në vitin 2021, në 131.25% në krahasim me vitin 2018. Ndërsa kontraktimet për 100 fshatrat rezultojnë me tendencë ulje. Grafikisht sa më poshtë vijon:



Pagesat për agroturizëm që janë në zonën e 100 fshatrave, në krahasim me totalin e paguar për agroturizëm apo turizëm rural, janë në masën 67.4%, grafikisht sa vijon:



Në mënyrë analitike sipas viteve paraqiten në aneksin nr. A, bashkëlidhur:

Në vitin 2019 dhe 2020, në masat e mbështetjes së turizmit rural dhe agroturizmit investimeve në territorin e 100 fshatrave ju është dhënë 10 pikë në kriteret konkurruese, ndërsa në vitin 2021, ju është dhënë 5 pikë në kriteret konkurruese.

🔧 Grupi i auditimit, auditoi 5 praktika të dhënies së grantit për financim të agroturizmit në 100 fshatrat. Nga auditimi i këtyre praktikave,¹³ ka rezultuar sa më poshtë vijon:

➤ K. N. M., Katund i Vjetër, Lezhë, Rubik, Mirditë, masa 45, ÷Mbështetje për investim në agroturizëm kundrejt planit të biznesit 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 milion lekë, sipas kontratës nr. 2802/7, datë 08.10.2018, me masë mbështetje financiare 50% të vlerës së investimit të pranuar 5,571,142 lekë. Për të cilin nga monitorimi ka rezultuar:

- Investimi nuk ka dhënë efekte te ecuria e të ardhurave. Referuar vitit të aplikimit (2018) nuk ka të ardhura. Në vitin 2019 të ardhurat janë në vlerën 657 mijë lekë, ndërsa në vitin 2020 të ardhurat janë në vlerën 223 mijë lekë, sipas vërtetimit për xhiron e tre viteve të fundit.

¹³ Burimi i të dhënave dokumentacioni i dosjeve të audituara, kontrollet ex-post.

- Investimi i financuar nuk ka ndikuar në objektin social në drejtim të rritjes së numrit të fuqisë punëtore. Në momentin e aplikimit ka parashikuar 8 punonjës. Në momentin e kontrollit ex post ka tre punonjës të punësuar dhe të siguruar.
- Objektivat e parashikuar në biznes plan nuk janë përmbushur pasi subjekti nuk ka rritje në të ardhura si dhe në drejtim të rritjes së numrit të të punësuarve.
 - F. S. Gj.i, Gjepalaj, Njësia Administrativë (NJA) Gjepalaj, Gjepalaj e poshtme, Durrës, masa 9 ÷ Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit 50% e vlerës totale e faturave tatimore, por jo më shumë se 10 milion lekë.ö, sipas kontratës nr.1331/8, datë 10.11.2021, me masë mbështetje financiare 50% të vlerës së investimit të pranuar në shumën 4,514,755 lekë.
 - H. Xh., agroturizëm ÷ U.ö, NJA Kurvelesh, fshati Rexhë, Bashkia Tepelenë, emri i markës ÷ Rexhinaö, masa e mbështetjes 45 ÷ Mbështetje për investim në agroturizëm kundrejt planit të biznesit 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 milion lekëö, kontrata nr. 2812/8, datë 29.10.2018, me masë mbështetje financiare 50% të vlerës së investimit të pranuar në shumën 7,014,609.64 lekë. Për të cilin nga monitorimi ka rezultuar:
 - Investimi ka dhënë efekt tek ecuria e të ardhurave të subjektit. Në momentin e aplikimit (viti 2018), deklarimi i të ardhurave ka qenë në vlerën 0 lekë, në vitin 2019 në shumën 2,630 mijë lekë dhe në vitin 2020 4,352 mijë lekë.
 - Investimi ka ndikuar në impaktin social në drejtim të rritjes së fuqisë punëtore. Në periudhën e aplikimit (2018) ka pasur të punësuar dhe të siguruar 3 punonjës. Në momentin e kontrollit ex - post ka 4 punonjës të punësuar dhe të siguruar.
 - Sh. H., Durrës, Manzë, Radë, masa e mbështetjes 45. Kontrata nr.2815/7, datë 08.10.2018, vlera e investimit të pranuar 20,611,343, financimi 50% por ji më shumë se 10 milion lekë. Për të cilin nga monitorimi ka rezultuar:
 - Investimi i financuar nuk ka dhënë efekte në të ardhurat e subjektit. Në vitin 2018, vit i investimit, të ardhurat ishin 53,546 mijë lekë. Në vitin 2019 të ardhurat ishin 53,546 mijë lekë. Ndërsa në vitin 2020 të ardhurat ishin 22,842 mijë lekë (duke konsideruar edhe faktin që ishte viti i pandemisë dhe aktivitetet e turizmit ishin përgjithësisht të pezulluara).
 - Investimi i financuar ka ndikuar në drejtim të rritjes së fuqisë punëtore. Në periudhën e aplikimit (në vitin 2018) ka patur të punësuar 17 punonjës. Në momentin e kontrollit ex-post ka 21 punonjës të siguruar.
 - Objektivat e parashikuara në planin e biznesit janë realizuar pjesërisht pasi nuk ka rritje në të ardhurat, por ka rritje në numrin e punonjësve të siguruar.
 - D. Z. Gj., Lëpushë, Shkodër, masa e mbështetjes nr.7, ÷ Mbështetje për ngritjen ose rikonstrukcionin e ambienteve për veprim të turizmit rural nga 6 ó 10 dhoma, 50% e vlerës por jo më shumë se 5 milion lekë. Përfituesit janë subjekte të cilat nuk mbështeten nga IPARD përkatësisht për investim instalim panele diellore dhe mobilim bujtineö. Kontrata nr. 1737, datë 01.09.2020, vlera e investimit 6,327,499 lekë, mbështetja 3,163,749 lekë.

Nga auditimet e kryera të këtyre praktikave rezultuan:

Gjetje nga auditimi:

13. Në AZHBR, në kontratat e lidhura midis palëve, afati i përcaktuar në lidhje me përfundimin e investimit për agroturizëm është përcaktuar brenda vitit buxhetor dhe jo bazuar në grafikun e punimeve të objektit sipas projektit të hartuar dhe të kontraktuar. Realizimi i një objekti varet nga grafiku i punimeve sipas kushteve teknike të ndërtimit dhe likuidimi i tij duhet kryer në varësi të realizimit të objektit. Për pasojë nga auditimi janë evidentuar raste të moskryerjes së investimit brenda vitit ushtrimor të cilat kanë çuar edhe në hartimin e kontratave shtesë me subjektet përfituese, duke argumentuar kërkesën e subjekteve kontraktore për afatin e kryerjes së investimit dhe realizimit të pagesave të mbartura në vitin pasardhës.

Konkluzion:

10. Përcaktimi i afateve sipas vitit buxhetor përbëjnë risk për përmbylljen e investimit në cilësinë e kërkuar.

Rekomandimi:

13.MZHBR, në bashkëpunim me MFE, të konsiderojë mundësinë e rishikimit të marrëveshjes dypalëshe për shtyrjen e afatit të përfundimit të investimit për masat mbështetëse në agroturizëm, bazuar në grafikun e punimeve sipas kushteve teknike të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në gjetjen nr. 14 të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AZHBR, është paraqitur komenti me nr. 2276/1/03 prot., datë 12.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/13, datë 12.07.2022, e firmosur nga znj. E. S., me detyrë Drejtore e Përgjithshme e AZHBR, ku janë shprehur komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit për krahasimin që duhej bërë nga inspektorët midis parashikimit në plan ó biznesin e paraqitur në aplikimin për financim, me rezultatet e monitorimit ex ópost.ó.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar dhe paraqitur dokumentacion argumentues, komenti juaj merret në konsideratë dhe gjetja (14) nuk do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Mbi kontratat e lidhura nga AZHBR.

Nga auditimi i kontratave të lidhura në AZHBR, për financim të agroturizmit pjese e projektit të 100 fshatrave, rezultoi se:

Në vitin 2018, nuk është parashikuar në asnjë nen të kontratës së financimit, paraqitja e kontratës së investitorit me mbikëqyrësin e punimeve dhe me kolaudatorin. Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është parashikuar në asnjë nen të kontratës së financimit, paraqitja e kontratës së investitorit me kolaudatorin, mungesa e të cilave mbart risqe për zbatimin e punimeve të objekteve.

Nga auditimi rezultoi se në dosjet e audituara gjendet vetëm libreza e masave dhe nuk evidentohen punimet e maskuara për t`u vërtetuar nga punonjësit e AZHBR që shkojnë për verifikim në vend, në kundërshtim me nenin 5, óPërgjegjësitë e përfituesitó të kontratave të lidhura në vitet 2019 ó 2021, pika 5.4¹⁴, midis të tjerave është përcaktuar dokumentacioni i kantierit, por nga auditimi rezultoi se në dosjet e audituara është vetëm libreza e masave dhe nuk janë punimet e maskuara për t`u vërtetuar nga punonjësit e AZHBR që shkojnë për verifikim në vend kjo nisur nga sa audituar ku thuhet se: *“Është punim i fshehte/ i maskuar dhe nuk vërtetohet”*.

Për likuidimin e vlerës së objektit të përcaktuar në nenin 6 óPagesaó, në pikën 6.2¹⁵, është përcaktuar dokumentacioni që shoqëron kërkesën për financim dhe rezultoi se likuidimi i

¹⁴ ó5.4 Përfituesi i Grantit është i detyruar të depozitojë Kontratën e lidhur me Mbikëqyrësin e punimeve të ndërtimit/ rikonstruksionit të licencuar, me afat deri në përfundimin e investimit, në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 óPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitó të ndryshuar. mbikëqyrësi /supervizionimi i punimeve duhet të dokumentojë të gjithë procesin e punimeve/ ndërtimeve / rikonstruksionit, bazuar në legjislacionin në fuqi duke hartuar, : proces verbalet e punimeve të maskuara, ditarin e punimeve, ndryshimet e projektit (nëse ka/ argumentimin ligjorë dhe miratimin nga AK) testet e kontrollit, certifikatat e materialeve të përdorura, foto gjate punimeve etj. Mbikëqyrësi i punimeve, bazuar në Kontratën e lidhur me Përfituesin, mban përgjegjësi për punimet e ndërtimit mbas përfundimit të investimitó.

¹⁵ ó6.2 Kërkesa për financim, do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, së bashku me kërkesën për financim, përfituesi paraqet dokumentacionin origjinal: Kërkesën për pagesë, sipas Aneksit 9; Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruksion Masa 9 dhe Masa 10); Faturën/faturat tatimore punimeve/pajisjeve, shoqëruar me vlerën ekonomike të elementëve përbërës, etj.; Akt zhdoganimit për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën të elementëve përbërës; Transaksionin bankar dhe/ose S IFT-in për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti tek shitësi. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësorë, etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për

vlerës së plotë të punimit të ndërtimit (rikonstruksion apo ndërtim) kryhet pa një akt kolaudimi duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e: UKM nr.3, datë 15.02.2001, òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, kapitulli II; dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, kap. III. òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreò, òDokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlereò, pika 61.

Konstatuam se, në kontrata nuk parashikohen masa ose penaltete (pika 7.7¹⁶) nëse gjatë kontrolleve rezulton se nuk është zbatuar plani i biznesit dhe nuk ka rritje të kapaciteteve të investimit/ prodhimit për të cilin është investuar, sikurse është përcaktuar në pikën 7.5, ku është përcaktuar se: *òPërfituesi i grantit nuk duhet të ndryshojë destinacionin e investimit për të cilin është shpallur fitues. Në rastet kur ai ndryshon destinacionin e investimin, përfituesi do shpallet debitor dhe duhet t'i kthejë Autoritetit Kontraktor shumën për të cilën është kontraktuar”*.

Nga auditimi i rezultoi se, preventivat e punimeve në përgjithësi dhe librezat e masave në veçanti, nuk shoqërohen me numra analize të zërave të punimeve sipas òManualit të çmimeve të punimeve ndërtimitò, bazuar në VKM nr.514, datë 15.08.2007, òPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimitò, pika 1¹⁷, si dhe nuk janë të shoqëruara me analiza të veçanta për ato zëra që nuk ka çmime në këto analiza, veprime në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.2.2001, òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò, Kapitulli I, òMbi mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimitò, pika 3.3¹⁸.

Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kontratave të lidhura në AZHBR, për financim të agroturizmit pjese e projektit të 100 fshatrave, rezultoi se:

14. Në vitin 2018, nuk është parashikuar në asnjë nen të kontratës së financimit, paraqitja e kontratës së investitorit me mbikëqyrësin e punimeve dhe me kolaudatorin. Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është parashikuar në asnjë nen të kontratës së financimit, paraqitja e kontratës së investitorit me kolaudatorin, mungesa e të cilave mbart risqe për zbatimin e punimeve të objekteve.

Nga auditimi i rezultoi se, preventivat e punimeve në përgjithësi dhe librezat e masave në veçanti, nuk shoqërohen me numra analize të zërave të punimeve sipas òManualit të çmimeve të punimeve ndërtimitò. Nuk evidentohen punimet e maskuara për t'u vërtetuar nga punonjësit e AZHBR që shkojnë për verifikim në vend. Për likuidimin e vlerës së objektit të

pagesë; Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë; Për investimet ku masa e financimit është me vlerë mbi 10 milionë lekë, dokumenti i sigurimit të investimit nga një kompani sigurimi, deri në vlerën e financimit nga AZHBR-ja; Certifikata e origjinës të makinerive/pajisjeve nga dhe Vërtetim nga AKU, që konfirmon përbushjen e standardeve përkatëse për sigurinë ushqimore (Masa 8)ò.

¹⁶ “7.7 Përfituesi ka detyrimin ligjor që të zbatojë me përpikmëri planin e biznesit mbi bazën e të cilit është shpallur fitues dhe është financiar, referuar rritjes së kapacitetit e investimit/prodhimit për të cilin është investuar si dhe për rritjen e efekteve sociale dhe ekonomike të cilat sjellin impakt në rritjen e punësimitò.

¹⁷ ò1. Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave e të analizës së kostos për punimet e ndërtimit, sipas programeve kompjuterike të miratuara për lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në këtë fushë, lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar të punimeve të ndërtimit dhe shmangien e informalitetit në veprimtarinë prodhuese, në tregun e ndërtimeve në Shqipëria

¹⁸ ò3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

përcaktuar në kontratë, është përcaktuar dokumentacioni që shoqëron kërkesën për financim dhe nga auditimi rezultoi se likuidimi i vlerës së plotë të punimit të ndërtimit (rikonstruksion apo ndërtim) kryhet pa një akt kolaudimi. Këto veprime janë jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të ndërtimit.

Në kontratë nuk parashikohen masa ose penalitete nëse gjatë kontrolleve rezulton se nuk është zbatuar plani i biznesit dhe nuk ka rritje të kapaciteteve të investimit/ prodhimit për të cilin është investuar.

Konkluzion:

11. Mungesa e plotësisht të kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për kryerjen e investimeve për 100 fshatrat, krijon kushte për cenimin e cilësisë së objekteve dhe si pasojë për mos përmbushjen e objektivit të këtij projekt në tërësi.

Rekomandime:

14. AZHBR të marrë masa që në lidhje me projektet pjesë e Programit të 100 fshatrave, të rishikojë nenet e kontratave ekzistuese dhe të reflektojë në kontratat e reja në vijim, ndryshimet në drejtim të: (i) paraqitjes së kontratës së investitorit, me mbikëqyrësin e punimeve dhe kolaudatorin; si dhe (ii) vendosjes së penaliteteve nëse gjatë kontrolleve rezulton se nuk është zbatuar plani i biznesit dhe nuk ka rritje të kapaciteteve të investimit/ prodhimit për të cilin është investuar.

15. Nga AZHBR, të merren masa që preventivat e punimeve për 100 fshatrat, të shoqërohen me numra analize të zërave të punimeve sipas Manualit të çmimeve të punimeve ndërtimit dhe në rastet kur nuk ka të tillë të paraqiten analizat e çmimeve të veçanta.

16. Nga ana e AZHBR të verifikohet se kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve të evidentojnë punimet e maskuara për t'u vërtetuar nga punonjësit e AZHBR që shkojnë për verifikim në vend;

17. Nga ana e AZHBR likuidimi i vlerës së plotë të punimit të ndërtimit të kryhet vetëm me paraqitjen e akt kolaudimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar AZHBR, është paraqitur komenti me nr. 2276/1/03 prot., datë 12.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/13, datë 12.07.2022, e firmosur nga znj. E. S., me detyrë Drejtore e Përgjithshme e AZHBR, ku janë shprehur komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për gjetjen nr.14, ku komentohet se: "Në kontratën tip të grantit duke filluar nga viti 2019 e në vazhdim, është shtuar detyrimi për përfituesit në nenin 5 Përgjegjësitë e Përfituesitë, pika 5.4ö.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar qëndrimi juaj është i njëjtë me të atë të grupit të auditimit për kontratat e vitit 2018 në lidhje me mbikëqyrësit, ndërsa për kolaudatorët e objekteve nuk është rregulluar nga ana e juaj sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore të fushës së ndërtimit.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për gjetjen nr.15, ku komentohet se: "Në zbatim të udhëzimit për skemat kombëtare, pika iv, "dokumente për kërkesa për financim", aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim, ku financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Së bashku me kërkesën për financim aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Për masën e agroturizmit, certifikatën e regjistrimit “Subjekt i certifikuar agroturizmi”;
- b. Situacionin e punimeve, faturën tatimore, librezën e masave;
- c. Faturat tatimore për blerjen e pajisjeve;
- d. Akt zhdoganimin për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit;
- e. Transaksionet bankare.

Përlllogaritjet e vlerave të autorizuara janë bërë bazuar në dokumentacionin e sipërcituar në udhëzim, sipas zërave të kontratës së grantit, ofertën fituese, faturat, situacionet, raporti i kontrollit dhe librezën e masave (punimet e fshehta). Të gjitha zërat e ndërtimeve dhe të paisjeve janë të pasqyruara me foto në raportin e kontrollit”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar ju sqarojmë se në dosjet e audituara gjendet vetëm librezë e masave dhe në asnjë rast nuk evidentohen punimet e maskuara për t'u vërtetuar nga punonjësit e AZHBR.

Komenti juaj se ato janë në librezën e masave nuk qëndron.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për **gjetjen nr.16**, ku komentohej se: “*Akti i kolaudimit është një dokument i cili nuk është kërkuar në udhëzimin përkatës për këtë masë*”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar ju sqarojmë se në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, ÷Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, ndryshuar, në nenin 1 të tij është përcaktuar: ÷Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për objektet në Republikën e Shqipërisë kontrollohen dhe disiplinohen në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe në nenin 2, është përcaktuar qartë se: ÷Ky ligj zbatohet për të gjitha projektimet dhe zbatimet e punimeve të ndërtimit që realizohen nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ju duhet ta shtoni dokumentin e kolaudimit të objektit në kërkesat tuaja.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për **gjetjen nr.17**, ku komentohej për penalitete e munguara në pikën 7.7 të kontratave se: “*janë në manualin e procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga buxeti i shtetit për vitin 2022*”, paragrafi 4, pika A 10”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa keni komentuar ju sqarojmë se kjo pjesë e manualit tuaj nuk është pjesë e kontratës së lidhur midis palëve, ku duhet të përcaktohen detyrimet kontraktuale.

Ju duhet ta shtoni në kushtet e kontratës *paragrafin 4, pikën A 10 të manualit në fjalë*.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për **gjetjen nr.18**, ku flitet për mungesën e numrit të analizave të çmimeve të ndërtimit për të cilën ju komentoni se: ÷Përlllogaritjet e vlerave të autorizuara janë bërë bazuar në zërat e kontratës së grantit, ofertën fituese, faturat, situacionet, raporti i kontrollit dhe librezën e masave (punimet e fshehta). Të gjitha zërat e ndërtimit dhe të pajisjeve janë të pasqyruara me foto në raportin e kontrollit”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa keni komentuar ju sqarojmë se ju nuk keni komentuar për çfarë flitet në këtë gjetje, pra për mungesën e numrit të analizës së çmimit të punimit të ndërtimit.

Sa trajtuar komenti juaj për këtë gjetje nuk qëndron.

IV.3 A kanë ndikuar procedurat e ndjekura nga strukturat MTM, AKPT, AZHBR për realizimin e “Programit të 100 fshatrave”?

IV.3.1 A i ka shërbyer realizimi i deritanishëm i “Programit të 100 fshatrave”, grupeve të synuara, (popullsia e zonave rurale, fermerët grupet e fermerëve, individë, në veçanti gratë dhe të rinjtë)?

Programi 100 fshatrat, është menduar dhe promovuar si një program i cili do të gjeneronte të ardhura shtesë për banorët e këtyre zonave, kjo nëpërmjet shtimit të shërbimeve turistike, infrastrukturës, etj.

Nga auditimi mbi destinacionet e krijuara deri në fund të vitit 2021 dhe mbi markat për agroturizmin në 100 fshatrat, sipas pyetësorëve të paraqitur nga MBZHR (*pyetësor i plotësuar nga Enea Hoti, ish-këshilltar në MBZHR*) dhe jo bazuar në dokumentacion, ka rezultuar se në përgjithësi për destinacionet e agroturizmit (pra, jo në veçanti për 100 fshatrat) sa vijon:

Janë krijuar dhe është patentuar marka e dyqaneve tradicionale të DUAÖ. Markë e regjistruar në DPPI dhe e menaxhuar nga FSHZH (aktualisht).

Janë mbi 15 produkte të regjistruara si produkte të mbrojtura. Bazuar në legjislacionin për produktet tradicionale dhe treguesit gjeografik. MBZHR ka hartuar legjislacionin përkatës përgjatë viteve 2019-2020.

Nëpërmjet mbështetjes së AZHBR janë mbi 70 bujtina dhe agroturizme që janë mbështetur financiarisht.

Janë certifikuar nga komisioni shtetëror i agroturizmit rreth 20 agroturizme të reja.

Në muajin mars 2022, edhe si rrjedhojë e Programit të 100 fshatrave si dhe mbështetjes së GIZ/SRD dhe kuadrit ligjor të krijuar për agroturizmin është krijuar për herë të parë Shoqata e Agroturizmeve të Shqipërisë.

Ndërsa në lidhje me infrastrukturën e gatshme për të gjithë zinxhirin e vlerës së produktit, duke filluar që nga ambientet dhe pajisjet e prodhimit/magazinimit, linjave të paketimit dhe të marketimit, mbështetje për standardizimin e certifikimit, si dhe hapësirë për shitje të produkteve po sipas pyetësorëve inkubatorët e produkteve tradicionale në Përmet dhe Malësi të Madhe, kanë filluar punën por janë në hapat e parë të funksionimit (vetëm 2 vjet). Në këtë kuptim ka akoma punë për konsolidimin e aspekteve prodhuese dhe menaxheriale për krijimin e zinxhirëve të vlerës së produkteve.

Për marka prodhimi të specializuara në shitjen e produkteve shqiptare, në veçanti produkteve tradicionale nga agroturizmi në përgjithësi është duke u punuar me produktet shqiptare potenciale për të regjistruar si produkte me emërtim tradicional, aktualisht të Mishavinao dhe të Djathi të Zierë, të cilat janë në proces vlerësimi (Malësi e Madhe).

IV.3.2 A është monitoruar realizimi i treguesve, për të matur impaktin që synon të arrijë PIZHR dhe a është përfshirë komuniteti në dëgjesa publike?

Bazuar në kontaktet e marra me banorë të zonave apo kryepërgjyeshorët e fshatrave rezultoi se dëgjesa publike janë kryer nga grupet e punës së Akademisë së 100 + fshatrave. (Komentet janë bashkëlidhur aneksit të fotove, bashkëlidhur).

Gjetje nga auditimi:

15. Bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, është përcaktuar impakti i përgjithshëm që synon të arrijë Programi i Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) i cili do të matet me tregues të matshëm dhe në hapësirën e përcaktuar të 100 fshatrave. Nëntë treguesit/indikatorët që synohen të arrihen nëpërmjet PIZHR-së konsistojnë në rritjen e numrit të: vendeve të punës; të punësuarve gra/vajza; e të punësuarve të rinj; bizneseve start-up, të bujtinave; numrin e inkubatorëve për produkte tradicionale; numrin e sipërmarrjeve të reja të agroturizmit; numrin e sipërmarrjeve prodhuese të produkteve

tradicionale; si dhe numrin e projekteve të realizuara të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Nuk na u vu në dispozicion asnjë e dhënë mbi realizimin e 9 indikatorëve të përcaktuar në Strategji dhe MZBHR si udhëheqëse e strategjisë, nuk ka hartuar një raport monitorimi/vlerësimi të tyre. Bazuar në pyetëtorët e përgatitur nga grupi i auditimit, pretendohet se ka pasur shkëmbim informacioni me institucionet dhe agjencitë zbatuese, ndërkohë që bazuar në kërkesat e bëra nga grupi i auditimit në arkivin e protokollin e kësaj Ministrie nuk ndodhej dokumentacioni vërtetues mbi të dhënat nga institucionet zbatuese të drejtpërdrejta (p.sh. FSHZH për projektet e infrastrukturës), AZHBR për projektet e financimit të bujtinave dhe agroturizimeve të reja, etj.

Konkluzion:

12. Nuk janë marrë masa për administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e Programit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve dhe të autoritetit përkatës. për realizimin e treguesve të matshëm të përcaktuar në hapësirën e 100 fshatrave dhe si pasojë nuk është kryer asnjë monitorim mbi matjen e indikatorëve të parashikuar dhe impaktin e këtij programi në tërësi.

Rekomandime:

18. MBZHR, MTM, MIE dhe MK si subjekte të ngarkuara për zbatimin e këtij programi, të marrin masa për të hartuar programe pune si dhe për të krijuar struktura të posaçme të cilat do të bëjnë të mundur administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e Programit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve dhe të autoritetit përkatës. për realizimin e treguesve të matshëm të përcaktuar në hapësirën e 100 fshatrave.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Nga ana e MBZHR, MTM, MIE dhe MK, të shikohet mundësia e krijimit të baze të dhënash të përbashkët me akses nga të gjitha njësitë e përfshira në këtë program, ku të evidentohen gjithë projektet, pjesë e programit për 100 fshatrat, në të cilën të pasqyrohen ndër të tjera investimet e kryera për çdo fshat dhe impakti i tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Në varësi të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive, të fillojë puna për vlerësimin e indikatorëve, bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, nëpërmjet kryerjes së monitorimeve periodike, për të matur impaktin që synon të arrijë PIZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar MBZHR, është paraqitur komenti me nr. 2079/05 prot., datë 27.07.2022, e protokolluar në KLSH me nr.108/15, datë 28.07.2022, ku janë shprehur komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kundërshtimin sa trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për gjetjen **nr.19**, ku komentohet se: Me kalimin e kompetencave tek koordinatori kombëtar MBZHR ka përgjegjësinë vetëm të pasqyrimin të të dhënave për investimet e kryera përmes skemave kombëtare të cilat do të merren nga AZHBR.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me sa komentuar nga ana e juaj ju bëjmë më dije se ju nuk keni paraqitur asnjë dokument zyrtar që kompetencat tuaja kanë kaluar tek koordinatori kombëtar.

V. PËRMBLEDHJA

✓ Në institucionet objekt auditimi MBZHR, MTM, MIE dhe MK, nuk ka patur: dokumente strategjike në lidhje me menaxhimin e programit 100 fshatrat të shoqëruar këto dhe me raporte monitorimi, relacione, vendime, udhëzime, analiza ose studime që lidhen me zhvillimin e programit 100 fshatrat. Gjithashtu nuk ka as plane pune vjetore të hartuara për periudhën e zbatimit të programit qeveritar për 100 fshatrat (2018-2021). MBZHR si drejtuese e strategjisë bazuar në VKM nr. 21, datë 12.1.2018, òPër disa shtesa në VKM nr. 709, datë 29.10.2014, òPër miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020, nuk ka përfshirë në raportet e monitorimit të kësaj strategjie, programin e 100 fshatrave.

✓ Afati 3 vjeçar i zbatimit të projektit nuk është në përputhje të plotë me vetë termin e òZhvillimit ekonomik, pasi konceptimi i këtij termi nënkupton procese që kërkojnë kohëzgjatje kohore më të gjatë.

✓ Nuk janë ngritur nga ana MBZHR, MTM, MIE dhe MK strukturat e posaçme, të cilat do të bëjnë të mundur administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e òProgramit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve dhe të autoritetit përkatës, për rrjedhojë nuk ka as monitorim të punës së kryer nga ana e tyre.

✓ Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në subjektet objekt auditimi rezultoi se komisioni ndërministror nuk ka funksionuar, pasi nuk ka asnjë të dhënë mbi përbërjen e këtij Komisioni dhe ndryshimet nëse ka, se nga kush udhëhiqet ky komision, minuta takimi të punës së tij, etj. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë se sa vendime janë marrë nga ana e këtij Komisioni në lidhje me çështjet që lidhen me administrimin, programimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e programit, sa projekt ide janë administruar në Komision dhe sa nga to janë miratuar, nëse ka dhe sa ka bashkëpunime me bashkitë dhe agjencitë rajonale të zhvillimit, si dhe me partnerë të tjerë publikë apo privatë, që janë të interesuar për të mbështetur programin e 100 fshatrave.

✓ Në MBZHR, nuk është ngritur Sekretariati Teknik, kërkesë e pikës 3.7.2 të VKM nr.21, datë 12.01.2018; Nuk ka të dhëna dhe dokumentacion mbi personat e kontaktit që janë ura lidhëse ndërmjet sekretariatit teknik dhe ministrive përkatëse, si dhe nuk ka persona kontakti aktualë. Këta persona kanë qenë në fillimet e projektit dhe nuk janë më në këto detyra si dhe nuk janë zëvendësuar. Mosfunksionimi i komisionit ndërministror ka sjellë edhe mos përcaktimin e detyrave të sekretariatit e për rrjedhojë mosveprimin nga ana e tij për informimin publik dhe transparencën e programit të 100 fshatrave, kërkesë e pikës 3.7.2 e VKM nr.21, datë 12.01.2018. Mosfunksionimi i sekretariatit teknik shoqërohet me mungesën e paraqitjes së dokumentacionit si: raportime periodike nga ministrinë në Sekretariat, raporte monitorimi si dhe njëkohësisht mungesën e një data bazë të dhënash (për çdo fshat) mbi gjendjen aktuale të programit 100 fshatrat, kërkesë kjo e pikës 3.7.2 të VKM nr.21, datë 12.01.2018. Mos ngritja de facto e Komisionit Ndërministror ka sjellë mos funksionimin e tij dhe ka bërë të pamundur realizimin e qëllimit të strategjisë dhe objektivave të programit.

✓ Programi 100 fshatrat duhet të mbaronte në vitin 2020. Edhe pse kanë kaluar dy vjet nga afati i përfundimit, ky program ende nuk ka përfunduar. Brenda afatit kohor 2018-2020 duhet të ishin përbushur këto objektiva: (1) Përmirësimi i infrastrukturës publike; (2) Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike; dhe (3) Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor.

✓ MZHR nuk ka kryer monitorime në investimet e kryera në sektorin e agroturizmit nëpërmjet skemës kombëtare për 100 fshatrat.

✓ Edhe për shpenzimet e kryera, rezultoi se nuk është zbatuar në të gjitha rastet kodi i programit 04230, por këto shpenzime kanë kaluar në kode programi të tjera.

✓ Nuk ka një data-bazë të dhënash me grupet e synuara të interesit ne zonat e 100 fshatrave si dhe nuk është arritur të matet impakti që kanë dhënë investimet e deritanishme në këto zona.

✓ Deri në këtë fazë të procesit të programit të 100 fshatrave, në kushtet edhe të mbarimit të afatit të zbatimit të tij, nuk ka një impakt të konsoliduar të outputeve të tij, pasi nuk është ngritur infrastruktura e nevojshme që diçka e tillë të bëhej e matshme.

VI. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE

1. L. B. *(p/grupi)*

2. A. B. *(anëtare)*

3. B. K. *(anëtar)*

4. Sh. B. *(anëtar)*

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

VII. SHTOJCAT

7/1 Foto dhe komente mbi gjëndjen në terren:

Fshati Boboshticë, Bashkia Korçë. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi Programin e 100 fshatrave dhe nga Bashkia Korçë për këtë projekt. Gjatë fazës fillestare, ai dhe një grup i madhë biznesesh të zonës dhe qarkut Korçë janë ftuar të marrin pjesë në Tiranë në një panair për të ilustruar dhe reklamuar punën dhe prodhimet tradicionale të tyre, por që pjesëmarrja në këtë panair nuk ka qenë në kuadrin e 100 fshatrave. Po kështu fshati Boboshticë është vizituar nga një grup specialistësh të Institucioneve Qendrore dhe studentë inxhinierë, deputetët e Korçës të kryesuar nga Kryeministri. Në kryqëzimin e rrugës Kolonjë-Ersekë dhe Boboshticë, Dardhë Arrëz, ndodhet një tabelë sinjalistike turistike e cila është vendosur nga Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me programin Franko - Shqipar dhe Institut Lælevageo.

Foto nr. 1 (hyrje në Boboshticë)



Nga AZHBR është marrë për sipër shtrimi i rrugës në hyrje të Boboshticës nga rruga kryesore deri në qendër të fshatit më një gjatësi 3,5 km. Ky investim nuk është bërë pasi këto fonde janë hedhur në fshatin Dardhë në një tjetër segment nga hyrja e Dardhës deri në kishën e Shën Pjetër me drejtim në Arrëz (nuk ka dijeni nëse është bërë në kuadër të këtij projekti). Investimi ka përfunduar në qershor të vitit 2021, i cili u konstatua fizikisht se ishte kryer nga ana e grupit të KLSH)

Foto nr. 2 (hyrje në Kryqëzimi i Dardhë – Arrës)



Fshati Arrëz, Bashkia Korçë. Përsa i përket investimit në kuadër të projektit 100 fshatrave nga FSHZH, për Arrëzën deri tani nuk është bërë asnjë investim, përveç një projekti që do realizohet për vitin 2022 (është bërë një takim nga përfaqësues të FSHZH me drejtues të fshatrave turistike të Devollit, Arrëzës, Sinicë, Qytezë dhe Bashkisë Devoll në ambjentet e Bashkisë, ku është kërkuar mendim për investimet dhe fushën e investimit). Ky investim ka të bëjë me kanalizimin e ujrave të bardha dhe të zeza, veshjen e rrugëve të brendshme të fshatit, rregullimin e fasadave dhe cative, për t'i kthyer në identitet, gurë dhe rasa guri.

Fshati Dardhë, Bashkia Korçë. Sipas Kryetarit të fshatit Julian Mekolli, në Dardhë ka 4 hotele dhe 6 shtëpi banimi të kthyer në bujtina për turistë. Nuk kanë marrë asnjë investim nga AZHBR, përveç z. A. S. në shumën 13.000.000 lekë, për shtesë hoteli, gjithashtu kanë marrë dhe si bletaritës z. A. S. dhe z. E. N.. Në fshatin Dardhë është bërë vetëm një investim, shtrim rrugë 3,5 km. Ky investim ka filluar në hyrje të fshatit Dardhë deri në kishën e Shën Pjetër me drejtim në Arrëz, për të cilën *nuk kanë dijeni nëse është bërë në kuadër të këtij projekti. Investimi ka përfunduar në qershor të vitit 2021, i cili u konstatua fizikisht se ishte kryer nga ana e grupit të KLSH*

Foto nr. 3 (tabelë në qendër Dardhë)



Fshati Mesopotam, Bashkia Finiq. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi ÒProgramin e 100 fshatrave. Fshati Mesopotam është vizituar nga një grup specialistësh të Institucioneve Qëndrore dhe studentë të rinj, por që nuk ka dijeni më tej se çfarë është bërë. Në qendrën e këtij fshati, i cila ndodhet në buzë të rrugës nacionale Delvinë - Sarandë ndodhen dy tabela info turistike nga MTM në kudin e projektit të 100 fshatrave. Në fshat nuk ka investime të tjera në kuadrin e këtij projekti.

Foto nr. 4 dhe 5 (tabela informuese MTM hyrje Mesopotam) Foto nr. 6 (tabela informuese MTM dalje Mesopotam)



Në hyrje të bashkisë Finiq ndodhet një tabelë e ish Ministrisë së Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes e cila nuk bën pjesë në projektin e 100 fshatrave.

Foto nr. 7 (tabelë informuese e MZHETTS në hyrje të bashkisë Finiq) Foto nr. 8 (tabelë informuese e MZHETTS në hyrje të bashkisë Finiq)



Fshati Rusan, Bashkia Delvinë. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi ÒProgramin e 100 fshatrave. Fshati Rusan është vizituar nga një grup specialistësh të Institucioneve Qëndrore dhe studentë të rinj, por që nuk ka dijeni më tej se çfarë është bërë. Në hyrje dhe dalje të e këtij fshati ndodhen dy tabela info turistike nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave. Në fshat nuk ka investime të tjera në kuadrin e këtij projekti
Foto nr. 9 (tabela informuese MTM hyrje Rusan) Foto nr. 9 (tabela informuese MTM dalje Rusan)



Fshati Çukë, Bashkia Sarandë. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi ÒProgramin e 100 fshatrave. Fshati Çukë është vizituar nga një grup specialistësh të Institucioneve Qëndrore dhe studentë të rinj, por që nuk ka dijeni më tej se çfarë është bërë. Në qendër dhe dalje të e këtij fshati ndodhen dy tabela info turistike nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave. Në fshat nuk ka investime të tjera në kuadrin e këtij projekti. Foto nr. 10 dhe 11 (tabela informuese MTM qendër Çukë)



Fshati Mursi, Bashkia Sarandë. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi Programin e 100 fshatrave. Fshati Çukë është vizituar nga një grup specialistësh të Institucioneve Qëndrore dhe studentë të rinj, por që nuk ka dijeni më tej se çfarë është bërë. Në qendër dhe dalje të e këtij fshati ndodhen dy tabela info turistike nga MTM në kadrin e projektit të 100 fshatrave. Në fshat nuk ka investime të tjera në kuadrin e këtij projekti

Foto nr. 11 dhe 12 (tabela informuese MTM hyrje Mursi)



Në hyrje të parkut të Butrintit ndodhet një tabelë informuese nga projektet të ndryshme e cila nuk bën pjesë në projektin e 100 fshtarave.
Foto nr. 13 (tabelë informuese parku në hyrje të Butrintit)



Në qendër të Porto Palermo ndodhet një tabelë informuese nga projektet të ndryshme e cila nuk bën pjesë në projektin e 100 fshtarave.
Foto nr. 14 (tabelë informuese Porto Palermo)



Në hyrje të Bashkisë Himarë ndodhet një tabelë informuese nga projektet të ndryshme e cila nuk bën pjesë në projektin e 100 fshtarave.
Foto nr. 15 (tabelë informuese Himarë)



Fshati Lukovë, Bashkia Himarë. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi ÕProgramin e 100 fshatrave. Fshati Lukovë nuk është vizituar nga specialistë apo të tjerë të caktuar në këtë projekt. Në qendër dhe dalje të këtij fshati nuk ka tabela info turistike të projektuara e të bëra nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave. Në fshat nuk ka investime të tjera në kuadrin e këtij projekti (përfshijto restaurimi i Kishës së Shën e Premtes)

Foto nr. 16 (*Kisha e Shën e Premtes*)



Fshati Vuno, Bashkia Himarë. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi ÕProgramin e 100 fshatrave. Fshati Vuno, është vizituar nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Në hyrje të e këtij fshati ndodhej vetëm një tabelë info turistike nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave. Në fshat nuk ka investime të tjera në kuadrin e këtij projekti

Foto nr. 17 (*tabelë informuese Vuno*)



Fshati Kaninë, Bashkia Vlorë. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi ÕProgramin e 100 fshatrave. Fshati Kaninë, është vizituar nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Në hyrje të e këtij fshati ndodhej vetëm një tabelë info turistike nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave. Në fshat nuk ka investime të tjera në kuadrin e këtij projekti

Foto nr. 18 (*tabelë informuese Kaninë*)



Fshati Drisht, Bashkia Shkodër. Nga takimi me Kryeplakun dhe Administratorin e Njesisë Postrisë rezulton se kishtin dijeni mbi òProgramin e 100 fshatraveò. Ky fshat është vizituar nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Nuk ka tabelë info turistike të projektuara bërë nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave. Administratorin, sqaron se rruga prej 8,5 km që të çon nga ura e Mesit me drejtim të qendrës së fshatit Drisht është bërë dhe projektuar në kuadrin e këtij projekti të 100 fshatrave.

Foto nr. 19 (*fshati Drisht*)



Fshatrat Mjedë dhe Zogaj, Bashkia Shkodër. Nga takimi me Kryeplaqtë rezulton se kishin dijeni mbi òProgramin e 100 fshatraveò. Këto fshatra janë vizituar nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Nuk ka tabelë info turistike të projektuara bërë nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave dhe nuk ka asnjë investim të kryer.

Fshatrat Fishtë dhe Ishull Lezhë, Bashkia Shkodër. Nga takimi me Kryeplaqtë dhe rezulton se kishtin dijeni mbi òProgramin e 100 fshatraveò. Këto fshatra janë vizituar nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Nuk ka tabelë info turistike të projektuara bërë nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave. Administratorin i Njesisë Bashkiake Blinisht, sqaron se investimi i vetëm i bërë është qendra shëndetësore Fishtë.

Foto nr. 20 (*tabelë informuese Fishtë*)



Fshati Roshnik. Nga takimi me Kryeplakun rezulton se kishtin dijeni mbi òProgramin e 100 fshatraveò. Ky fshat është vizituar disa herë nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Nuk ka tabelë info turistike të projektuara bërë nga MTM në kudrin e projektit të 100 fshatrave. Nga takimi me z. P. F. ish administratoj i kësaj komune dhe pronar i Bujtinës òA.ò rezulton se është përfituar një grant në vlerën 7,735.288 lekë në kuadrin e këtij projekti.

Foto nr. 21 (*tabelë informuese Roshnik*) Foto nr. 22, 23 dhe 24 (*tabelë informuese Bujtina A. - Roshnik*)



Fshatrat Kapinovë dhe Kozare, Bashkia Kuçovë. Nga takimi me Kryeplaqtë dhe rezultojnë se kishin dijeni mbi òProgramin e 100 fshatrave. Këto fshatra janë vizituar nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Nuk ka tabelë info turistike të projektuara bërë nga MTM në kudin e projektit të 100 fshatrave. Foto nga fshati Kozare- Kuçovë:



Fshati Stengopullos, Bashkia Gjirokastër. Nga takimi me Kryeplakun rezultojnë se kishte dijeni mbi òProgramin e 100 fshatrave. Ky fshat është vizituar nga specialistë dhe të tjerë të

caktuar në këtë projekt. Nuk ka tabelë info turistike të projektuara bërë nga MTM në kadrin e projektit të 100 fshatrave. Nga verifikimi në terren rezulton se Kisha e Shën Ilias në Stengopullos ishte restaruar plotësisht nga MK. Foto nr. 25, 26 dhe 27 (tabelë informuese Kisha e Shën Ilias – Stengopullos – pamjet e brendshme)



Fshati Shtërmen, Bashkia Elbasan. Nga takimi me Kryeplakun e këtij fshati rezulton se kishte dijeni mbi Programin e 100 fshatrave. Fshati Shtërmen, është vizituar nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Në hyrje të këtij fshati ndodhej vetëm një tabelë info turistike nga MTM në kadrin e projektit të 100 fshatrave dhe nuk ka investime të tjera në kadrin e këtij projekti

Foto nr. 27 (tabelë informuese fshati Shtërmen)



Fshati Kallm (Currila Durrës), Bashkia Durrës. Nga në terren në hyrje të e këtij fshati ndodhet vetëm një tabela info turistike nga MTM. Në fshat nuk ka investime të tjera në kuadrin e këtij projekti.
Foto nr. 28 (tabelë informuese Currila - Kallm)



Fshati Gjepal, Bashkia Durrës. Ky fshat është vizituar disa herë nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Nuk ka investime në infrastrukturë dhe nuk ka tabelë info turistike të projektuara bërë nga MTM në kadrin e projektit të 100 fshatrave. Nga takimi me Administratirin e Agroturizëm Gj, ky i fundit ka përfituar një grant në vlerën 10.000.000 lekë në kuadrin e këtij projekti.

Foto nr. 30, 31 dhe 32 (tabelë informuese Agroturizëm Gjepali)



Fshatrat Kosinë dhe Leusë, Bashkia Përmet. Ky fshat është vizituar nga specialistë dhe të tjerë të caktuar në këtë projekt. Nuk ka investime në infrastrukturë dhe nuk ka tabelë info turistike të projektuara bërë nga MTM në kadrin e projektit të 100 fshatrave. Foto nr. 32 (tabelë informuese fshati Leusë)



7/2 Anekse:

Aneksi. A -Lista e agroturizmit dhe turizmit rural në total dhe për 100 fshatrat në veçanti

Nr.	Emri	Kapaciteti Shtreter	Masa	Nr punonjesve	Qarku	Bashkia	Fshati	100 Fshatrat	Vlera e grantit	Vlera paguar	Start up	Monitorim
Viti 2018												
1	A. C.	18	Agroturizem	7	Tirane	Tirane	Shengjergj	po	7,957,850	7,957,850	po	po
2	A.F.	18	Agroturizem	4	Berat	Berat	Roshnik	po	7,735,288	7,735,288	po	po
3	K. shpk	18	Agroturizem	14	Durres	Durres	Gjepalaj	po	10,000,000	10,000,000	po	po
4	L. N.	18	Agroturizem	6	Berat	Polican	Peshtan	jo	18,928,982	8,989,665	jo	po
5	O. O. E. shpk	18	Agroturizem	4	Gjirokastër	Tepelene	Nivice	po	10,000,000	10,000,000	po	po
6	Sh. H.	18	Agroturizem	17	Durres	Durres	Rade	po	9,517,313	9,517,313	jo	po
7	F. K.	18	Agroturizem	4	Lezhe	Mirdite	Fushe Lumth	jo	10,000,000	9,986,267	jo	po
8	V. Xh.	28	Agroturizem	5	Korçë	Korçë	Boboshticë	po	2,536,715	2,536,715	po	po
9	N. B.	18	Turizmi Rural	2	Korçë	Pogradec	Lin	po	1,500,000	1,500,000	po	po
10	K. M.	18	Agroturizem	16	Lezhe	Lezhe	Katund I vjeter	po	5,170,752	5,170,752	jo	po
11	G. P.	18	Turizmi Rural	1	Gjirokastër	Permet	Leuse	po	1,500,000	1,500,000	po	po
12	Q.A.	18	Turizmi Rural	4	Tirane	Vore	Preze	po	1,319,649	1,319,649	jo	po
13	Q. A.	18	Agroturizem	4	Vlorë	Vore	Preze	po	9,447,454	9,447,454	po	po
14	J. H.	15	Turizmi Rural	7	Diber	Bulqize	Lepurake	jo	1,291,845	1,291,845	po	po
15	H. Xh.	24	Agroturizem	10	Gjirokastër	Tepelene	Nivice	po	2,104,383	2,104,383	po	po
16	D. Z.	18	Agroturizem	3	Diber	Diber	Melan	jo	3,000,000	3,000,000	jo	po

Nr.	Emri	Kapaciteti Shtreter	Masa	Nr punonjeseve	Qarku	Bashkia	Fshati	100 Fshatrat	Vlera e grantit	Vlera paguar	Start up	Monitorim
17	Q.shpk	40	Agroturizem	3	Durres	Kruje	Qafshatame	jo	2,873,441	2,873,441	jo	po
Totali 2018		341		111					104,883,672	94,930,622		
Viti 2019												
1	M. K.	24	Turizem Rural	1	Gjirokastër	Gjirokastër	Labove e Kryqit	jo	4,923,464	4,922,995	po	jo
2	D. Gj.	30	Turizem Rural	1	Shkoder	M.Madhe	Lepushe	po	4,977,736	4,114,215	jo	jo
3	K. I.	18	Turizem Rural	2	Diber	Diber	Melan	jo	4,916,745	4,517,492	jo	jo
4	G. J.	21	Turizem Rural	1	Gjirokastër	Permet	Leuse	po	4,131,922	4,122,755	po	jo
Totali 2019		93		5					18,949,867	17,677,457		
Viti 2020												
1	D. Gj.	15	Turizem Rural	1	Shkoder	M.Madhe	Lepushe	po	2,353,750	2,353,750	jo	jo
2	M. P.	13	Turizem Rural	1	Shkoder	Puke	Puke	jo	4,935,289	4,935,289	po	jo
Totali 2020		28		2					7,289,039	7,289,039		
Viti 2021												
1	A. Gj.	16	Agroturizem	14	Durres	Durres	Gjepalaj	po	8,227,073	4,477,755	jo	jo
2	F. O. shpk	33	Agroturizem	1	Shkoder	M.Madhe	Boge	jo	9,293,250		jo	
3	Th. L.	11	Turizem Rural	1	Gjirokastër	Gjirokastër	Labove e Sip.	po	4,926,560		po	
4	V. Ll.	6	Turizem Rural	1	Lezhe	Mirdite	Munell	jo	4,180,509		po	
Totali 2021		66		17					26,627,392	4,477,755		
TOTALI		528		135					157,749,970	124,374,873		

Burimi i të dhënave AZHBR

Aneksi B: Tabela mbi projektet e 100 fshatrave nga FSHZH, te cilat janë në fazat fillestare:

Qarku	Bashkia	Fshati	Emërtimi i Objektivit	Programi	Financues	Vlera e investimit (ALL)	Statusi aktual
TBD	TBD	TBD	Ndërhyrje për përmirësimin e shërbimeve publike të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane në zonat e 100 fshatrave	Programi i integruar në 100 fshatrat	GOA	50,000,000.00	Në fazë përgatitje TORs
Elbasan	Belsh	Dushk	Ndërhyrje për kultivimin e tokave ke me drure frutore/arrorë/vreshta, etj me qëllim përmirësimin e biodiversitetit, ekonomisë bujqësore si dhe duke rritur ardhurat ke dhe përmirësuar peisazhin rural nëpërmjet. Ngritjes së fermës organike 44 ha me bime medicinale, në Bashkinë Belsh	Programi integruar në 100 fshatrat	GOA	42,311,408.40	Në proces zbatimi
Korçë	Kolonjë	Taç Poshtë dhe Taç Qendër	Ndërhyrje për kultivimin e tokave ke me drure frutorë/arrorë/vreshta, etj me qëllim përmirësimin e biodiversitetit, ekonomisë bujqësore si dhe duke rritur të ardhurat ke dhe përmirësuar peisazhin rural nëpërmjet ngritjes së fermës organike me të mbjella arorë në Bashkinë Kolonjë	Programi i integruar në 100 fshatrat	GOA	57,688,590.60	Në proces prokurimi

Territori i 100 fshatrave	Territori i 100 fshatrave	Territori i 100 fshatrave	Ndërhyrje për krijimin e produktit autentik ushqimor lokal duke krijuar menunë e 100 Fshatrave	Programi i integruar ne 100 fshatrat	GOA	50,000,000.00	Në proces prokurimi
TBD	TBD	TBD	Ndërhyrje në përmirësimin e zinxhirit të vlerës për bimët medicinale/eterovajore/frutat e pyllit	Programi i integruar në 100 fshatrat	GOA	200,000,000.00	Në fazë përgatitje TORs
TBD	TBD	TBD	Ndërhyrje në përmirësimin e zinxhirit të vlerës dhe fuqizimit të produktit artizanal	Programi integruar ne 100 fshatrat	GOA	150,000,000	Në fazë përgatitje TORs
Territori i 100 fshatrave	Territori i 100 fshatrave	Territori i 100 fshatrave	Ndërhyrje për promovimin e zonave të 100 fshatrave nëpërmjet eventeve kulturore/sportive/kulinarie/sociale, etj	Programi integruar në 100 fshatrat	GOA	180,000,000	Në proces prokurimi
Territori i 100 fshatrave	Territori i 100 fshatrave	Territori i 100 fshatra	Ndërhyrje për përmirësimin e konektivitetit dhe rrugëve te aksesit në zona	Programi integruar në 100 fshatrat	GOA	392,343,000	Në proces zbatimi
TBD	TBD	TBD	Ndërhyrje për përmirësimin e infrastruktures turistike që lidhet sportet natyrore, aktivitetet në natyre, ecjen, etj/ Masterplani i sporteve	Programi integruar në 100 fshatrat	GOA	98,208,007	Në proces prokurimi
Vlorë	Vlorë	Tragjas	Ndërhyrje për përmirësimin e mjedisit dhe peisazhit urban të zonave nëpërmjet ndërhyrjeve që evokojnë traditën dhe autenticitetin e zonave/ Masterplani mbi 100 fshatrat	Programi i integruar në 100 fshatrat	GOA	245,920,078	Në proces prokurimi
Vlorë	Selenicë	Plllocë/Vajzë					
Vlorë	Himarë	Kuç					
Shkodër	Malësi e Madhe	Lepushe/Vermosh					
Kukës	Kukës	Shishtavec					
	Tropojë	Curraj i Epërm					
Elbasan	Librazhd	Fushe studen- steblevë					
	Prrenjas	Sutaj					
Dibër	Dibër	Radomirë					
Fier	Mallakastër	Hekal/Klos					
	Belsh	Seferan					
Korçë	Devoll	Qyteze/Arrëz/Sinic					
	Kolonjë	Rehovë					
	Përmet	Leus					
Gjirokastrë	Dropull	Sotir					
Shkodër	Shkodër	Selcë	Ndërhyrje zhvilluese të integruara për rritjen dhe diversifikimin e ofertës turistike në zona të caktuara	Programi i integruar ne 100 fshatrat	GOA	394,886,404	Në proces prokurimi
Vlorë	Himarë	Kallarlat					
Fier	Divjakë	Senës					

Burimi i të dhënave tabela total e paraqitur nga FSHZH ne MBZHR

Aneksi C: Tabela total e paraqitur nga FSHZH në MBZHR si punë e kryer për 100 fshatrat:

Qarku	Bashkia	Fshati	Emërtimi i Objektivit	Programi	Financues	Vlera e investimit (ALL)	Statusi aktual
Berat	Berat	Qafë Dardhë dhe Roshnik	Përmirësimi i potencialit turistik të siteve natyrore në rajonin e Beratit. duke përmirësuar aksesin dhe turizmin e aventures në Parkun e Tomorrit, luginën e Osumit, Drobonik, Roshnik dhe Sistemi i Muzeve dhe atraksioneve të Beratit	Programi për turizmin	BERZH - BE	669,788,328	Ne përgatitje termave referencës të
	Kuçovë	Kozare	Sistemim asfaltim i rrugës Cërrik - Belsh - Kuçovë - Ura Vajgurore, Faza e Trete	Rrugët prioritare - GOA	GOA	827,984,567	Përfunduar
	Poliçan	Kapinovë	Rikonstruksioni i rrugës Prokucë-Bodurr- Kapinovë, Loti 1 Dyte, L = 10,2 km)	IVR 2019-2021	GOA	543,680,738	Vlerësim projekti
Dibër	Dibër	Lurë	Rindërtimi dhe përmirësimi i rrugës Perlat - Fushë Lurë dhe përmirësimi i rrugës Fushe Lurë - Arras	Programi për turizmin	BERZH	2,839,058,686	Në prokurim
		Radomirë	Rikonstruksioni i rrugës Rrugë nacionale (Ceren) - Radomirë	IVR 2019	GOA	96,887,812	Përfunduar
	Bulqizë	Radisht	Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike Peshkopi Llixha	IVR 2020	GOA	14,912,802	Përfunduar
			Sistemimi i përroit të Llixhave Ura e Pazarit -Llixha dhe rikualifikimi Urban	IVR 2020	GOA	150,281,750	Zbatim
		Zerqan	Sistemim Asfaltim tre cezmat Zerqan Ndertim rrugë Zgozht - Ura e Cerencit	IVR 2019 BERZH - Konektiviteti	GOA BERZH	100,403,605 914,748,996	Vlerësim projekti Zbatim
Durrës	Shijak	Metallaj	Rikonstruksion i rrugeve lagjia e re Metallaj, lagjia e re Bodinak	IVR 2019-2021	FZHR2019	144,499,170	Vlerësim projekti
Elbasan	Belsh	Seferan	Rikonstruksioni i rrugës Cërrik -Belsh Kuçovë- Ura Vajgurore: Segmenti Grekan - Dragot 8.35 km	IVR 2017-2019	GOA	743,653,778	Përfunduar
	Librazhd	Stebleve	Ndërhyrje e Integruar Belsh	IVR 2019-2021	GOA	157,919,761	Zbatim
	Përrenjas	Rrajcë/Skënderbej	Ndërhyrje e integruar në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë	IVR 2019-2021	GOA	150,000,000	Vlerësim projekti
